



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 232 Akti**

**Nr. 272 Vendimi**  
**Tiranë, më 8.7.2020**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	kryesuese
<b>Roland Ilia</b>	relator
<b>Firdes Shuli</b>	anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 30.6.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Rozeta Qirjaqi (Goskova)**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoj relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoj subjektin e rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi (Goskova), vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Firdes Shuli dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.11.2018 u caktua me mirëkuptim kryesues znj. Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.6.2020 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.6.2020, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi (Goskova).*

10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2020.

11. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke filluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e rivlerësimit, në datën 3.6.2020 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Në datën 11.6.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 16.6.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 24.6.2020.

14. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen, ka marrë një kopje të saj dhe ka dërguar shpjegimet e saj në rrugë zyrtare, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, në datën 26.6.2020 vendosi të ftojë znj. Rozeta Qirjaqi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë me *e-mail* në datën 26.6.2020.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më 30.6.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Znj. Rozeta Qirjaqi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) administruar raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) administruar raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Nisur nga fakti se konstatimet e gjetura rezultuan mbi të tria kriteret e vlerësimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e këtyre gjetjeve.

## **A. VLERËSIMIN E PASURISË**

### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së saj dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka pasaktësi në deklaratat e interesave private ndër vite;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, Vetting” dhe aktit me nr. indeksi \*\*\*, datë 13.2.2018, të kontrollit të ILDKPKI-së për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për vitet 2003 - 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

## Në deklaratën e pasurisë “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

**1. Tokë truall** me sip. 300 m<sup>2</sup>, me adresë: \*\*\* (sot \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*) Korçë, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 25.9.1996, regjistruar në hipotekë sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 1.10.1996. Vlera e blerjes: 300,000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat familjare.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

Rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 25.9.1996, është blerë nga subjekti pasuria truall me sip. 300 m<sup>2</sup>, nga pala shitëse S.V., e ndodhur në Lagjen \*\*\* të qytetit të Korçës. Vlera e blerjes së pasurisë sipas kontratës rezultoi në shumën 300,000 lekë.

Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, dorëzuar në ILDKPKI, është deklaruar nga subjekti “tokë truall me sip. 300 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 1996 në vlerën 300,000 lekë nga të ardhurat familjare”.

Komisioni për këtë pasuri ka pyetur subjektin me qëllim deklarimin dhe provimin e të ardhurave të ligjshme familjare në vitin 1996, që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 300,000 lekësh, si burim për blerjen e kësaj pasurie.

Në përgjigje të pyetësorit nga subjekti është deklaruar se:

*“Sqaroj se pasi jam kthyer nga Greqia, ku kam jetuar me bashkëshortin A.Q., në emigracion, në periudhën mars 1995 deri në tetor 1998, kam banuar në shtëpinë e prindërve bashkë me vajzën (e cila ka qenë e vogël në atë periudhë). Shpenzimet e jetesës janë paguar në pjesën më të madhe nga të ardhurat e prindërve (të ardhura nga pensionet dhe nga prodhimet bujqësore si rezultat i punës së tyre në tokën që babai im ka marrë në përdorim dhe më pas në pronësi si bashkëthemelues i Ndërmarrjes Bujqësore në qytetin e Korçës, si dhe të ardhura nga puna në emigracion e vëllait I.G.,).*

*Sqaroj se kontributi im për shpenzimet ka qenë minimal (për vetë kushtet e kohës referuar indeksit të lekut dhe standardit të jetesës në këtë periudhë), pasi prindërit më kanë mbuluar shpenzimet për jetesën e përditshme, jo vetëm për faktin se kanë pasur të ardhura dhe mundësi ekonomike, por dhe për faktin se vëllai im I.G., në atë periudhë ka qenë dhe ka punuar në emigracion në Greqi (emigrant ekonomik që nga viti 1991). Në këtë mënyrë kam krijuar kursime nga të ardhurat kryesisht nga paga në vitet 1994, 1995 dhe 1996, duke mundësuar blerjen e truallit në vlerën 300.000 lekë në datën 25.9.1996. Për këto deklarime paraqes dhe provat përkatëse që disponoj.”*

### Analiza financiare e mundësisë së blerjes së tokës me sip. 300 m<sup>2</sup> në vitin 1996

Të ardhura Rozeta Qirjaqi 1994 – shtator 1996	395,700
Shpenzime jetese 1994 – shtator 1996	276,990
Blerë tokë në datën 25.9.1996	300,000
<b>Pamundësi financiare</b>	<b>-181,290</b>

Në analizën financiare janë llogaritur nga Komisioni të ardhurat e subjektit, duke zbritur shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – 1996, për të provuar mundësitë e subjektit për blerjen e kësaj pasurie.

### **Në përfundim të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës lidhur me:**

- Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ishte në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1996, në vlerën prej -181,290 lekësh.
- Subjekti i rivlerësimit ftohet të paraqesë shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni dhe të provojë mundësitë dhe burimet financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

### **Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur dhe deklaruar:**

*“Në lidhje me analizën financiare të blerjes së tokës 300 m<sup>2</sup> në vlerën 300,000 lekë në vitin 1996, theksoj se vlera prej 276,990 lekësh për shpenzime jetese 1994 – shtator 1996, e llogaritur në analizë, nuk është shpenzuar nga ana ime, sepse, siç kam deklaruar, unë nuk jetoja vetëm, por së bashku me prindërit dhe shpenzimet e jetesës janë mbuluar nga kursimet e prindërve, të cilat nuk janë llogaritur në analizë (burimet e të ardhurave të prindërve janë nga aktiviteti privat i tregtimit të prodhimeve bujqësore dhe pensionet, si dhe të ardhura nga vëllai I.G., emigrant në Greqi që prej vitit 1991, i cili ka ndihmuar ndër vite financiarisht familjen për mbulimin e shpenzimeve të jetesës).*

*Për sa më sipër, po ju paraqes si provë/dëshmi: deklaratën noteriale të prindërve me nr. \*\*\*, datë 12.3.2020, ku deklarohet se në moshën e pensionit kanë punuar tokën në përdorim dhe kanë ushtruar aktivitet tregtar duke shitur prodhime bujqësore në treg; deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 12.3.2020 të shtetas A.L.; deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.6.2020 të shtetasve A.Gj., dhe E. C., të cilët konfirmojnë faktin e shitjes së produkteve bujqësore nga babai H.G., në ish-markatën e fruta-perime në qytetin e Korçës, që nga periudha kur ka marrë tokën bujqësore në përdorim. Për periudhën në fjalë, referuar legjislacionit në fuqi të asaj kohe, prindërit nuk janë pajisur me NIPT apo licencë, por kanë ushtruar aktivitetin si tregtarë ambulantë në tregun e fruta-perimeve në qytetin e Korçës.*

*Disponimi i tokës bujqësore nga babai që nga viti 1991 konfirmohet nga provat dokument - akti i marrjes së tokës në përdorim, me sipërfaqe toke prej 9 dynym, nga e cila sillte të ardhura shtesë (mesatarisht rreth 20,000 lekë/muaj nga tregtimi i prodhimeve bujqësore që nga viti 1992 deri në vitin 2006). Fakti që konsumonim nga këto prodhime (si të ardhura në natyrë) dhe nuk shpenzonim për blerjen e tyre konfirmon që shpenzimet e jetesës kanë qenë realisht më të ulëta se shuma e llogaritur në këto vite në analizë.*

*Gjithashtu, vëllai ka punuar si emigrant ekonomik në shtetin grek që prej vitit 1991 dhe është pajisur me dokumentacion të rregullt qëndrimi pas vitit 1998, duke ndihmuar financiarisht familjen, me të ardhura nga puna në emigracion në shtetin grek, në ardhjet e tij periodike, rrethana këto që konfirmohen nga dokumentet origjinale të qëndrimit në shtetin grek, librezat e punësimit në ndërtim dhe vepra arti lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore të shtetit grek (IKA), si dhe nga vërtetimet me vulë apostile për pagesat e sigurimeve shoqërore, sektori i ndërtimit. Pra, vëllai rezulton me dokumentacion të rregullt në emigracion pas periudhës 1998 e në vijim.*

*Si përfundim, referuar analizës financiare të blerjes së tokës duhet të zbriten shpenzimet e jetesës.”*

Trupi gjykues konstaton se subjekti nuk arriti të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni, ose të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së krijuar.

Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1996 në vlerën prej -181,290 lekësh.

**Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të një pjese të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në referim të Aneksit D, të pikës 3 të Kushtetutës dhe të ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.**

**2. Shtëpi banimi** (ndërtuar në vitet 2004 - 2006 në truallin e mësipërm) me sip. 141 m<sup>2</sup>, me leje ndërtimi nr. \*\*\*, datë 13.4.2004, hipotekuar në ZVRPP Korçë me certifikatë pronësie nr. pasurie \*\*\*, datë 20.6.2006, për ndërtesën së bashku me truallin. Është sqaruar se vlera e ndërtimit bazë është 4,600,000 lekë (sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 21.6.2004, të Zyrës së Urbanistikës, Bashkia Korçë), por janë kryer edhe punime shtesë ekstra në ambientet brenda shtëpisë, si dhe shpenzimet për mobilim, të cilat në total përbëjnë vlerën e banesës 7,000,000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat nga puna në emigracion e bashkëshortit, të konkretizuara në dy depozitat bankare në Bankën e Kursimeve Korçë (sot “Raiffeisen Bank”), kursime nga paga si subjekt deklarues (në depozitën bankare në Bankën e Kursimeve Korçë, sot “Raiffeisen Bank”) dhe interesa bankare ndër vite nga këto depozita të pakësuara totalisht dhe mbyllur në vitet 2004 - 2006.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Për këtë pasuri është lëshuar certifikatë pronësie në datën 20.6.2006, nga ZVRPP-ja Korçë, ku përcaktohet sipërfaqja e truallit prej 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 141 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit.

Kjo pasuri rezulton e ndërtuar në bazë të lejes së ndërtimit të lëshuar në datën 21.6.2004, nga KRRT-ja Korçë. Bazuar në lejen e ndërtimit subjekti i rivlerësimit do të ndërtonte banesë dhe dyqan. Afati i lejes së ndërtimit për përfundimin e ndërtimit të objektit ishte caktuar data 13.4.2006.

Për lejen e ndërtimit subjekti i rivlerësimit ka paguar taksë investimi, sipas mandatarkëtimit të datës 21.6.2004, në shumën e 2 % të vlerës së investimit, në vlerën 93,900 lekë. Bazuar në këtë pagesë të kryer vlera e investimet për ndërtimin e këtij objekti është në shumën 4,695,000 lekë.

Subjekti ka deklaruar se vlera e ndërtimit të objektit ndërtimor është 4,600,000 lekë dhe vlera totale e shpenzuar për këtë pasuri është 7,000,000 lekë, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues lidhur me këtë pasuri të deklaruar.

Në deklaratën periodike vjetore të dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2003, subjekti ka deklaruar gjendje të llogarisë bankare të bashkëshortit në vlerën 5,000,000 lekë. Burimi i krijimit janë të ardhurat e përfituara nga emigracioni, kursimet nga paga dhe interesat bankare.

Në deklaratën periodike vjetore të dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2004, subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri apo investime dhe shpenzime të kryera mbi këtë pasuri. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar as ndryshim likuiditeti bankar të kryer për vitin 2004.

Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2005 subjekti ka deklaruar:

- *Ndërtuar një shtëpi banimi me sip. 141 m<sup>2</sup> në vitin 2004, në Lagjen \*\*\*, në truallin e deklaruar më parë, me leje ndërtimi nr. \*\*\*, datë 13.4.2004, lëshuar nga Bashkia Korçë, e pa hipotekuar, në vlerën 7,000,0000 lekë. Subjekti zotëron 50 % dhe bashkëshorti 50 %.*



- Pakësuar depozitë bankare në vlerën 5,000,0000 lekë në Bankën e Kursimeve Korçë.
- Dhuratë në lekë cash datë 20.12.2005, në shumën 400,000 lekë nga I.G., (emigrant në Greqi).

Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006 subjekti ka deklaruar:

- Përfunduar ndërtimi i një shtëpie banimi (të deklaruar) me sip. 141 m<sup>2</sup> dhe truall me sip. 300 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP Korçë, në z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, me certifikatë pronësie datë 20.6.2006, në vlerën 7,000,000 lekë. Zotërimi: 100 %.
- Mbyllur depozita bankare në "Raiffeisen Bank", dega Korçë, në datën 3.11.2006, në shumën 510,972 lekë. Zotërimi: 100 %.
- Çelur depozitë bankare në "Banka Amerikane", dega Korçë, në datën 10.11.2006, në shumën 5,000 USD. Zotërimi: 100 %.

Komisioni bëri një vlerësim të kësaj pasurie duke u bazuar në të dhënat dhe çmimet e tregut. Bazuar në çmimin e Entit Kombëtar të Banesave në qytetin e Korçës për vitet 2004 – 2006, rezultoi se çmimi mesatar<sup>1</sup> për koston e ndërtimit është në vlerën 24,793 lekë/m<sup>2</sup>. Bazuar në këto të dhëna vlere e ndërtimit për objektin me sip. 141 m<sup>2</sup> do të rezultonte në shumën 3,495,813 lekë.

Nga verifikimi i planimetrisë së objektit ndërtimor duket se vetëm sipërfaqja e katit të parë të objektit ndërtimor është rreth 141 m<sup>2</sup> dhe duke llogaritur që objekti është 2 kate atëherë sipërfaqja e përgjithshme duket se është 282 m<sup>2</sup>. Bazuar në çmimin mesatar për koston e ndërtimit për vitet 2004 - 2006 vlere e këtij objekti, sipas çmimeve të EKB-së, llogaritet në shumën 6,991,720 lekë.

Kësaj vlere të llogaritur, Komisioni, në vlerësimin financiar, i shtoi edhe shumat e deklaruara të shpenzuara nga subjekti në vlerën prej 1,200,000 lekësh për punime shtesë dhe vlerën prej 1,200,000 lekësh për shpenzimet e arredimit.

Për këtë pasuri Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit:

- Në deklaratën "Vetting" keni deklaruar: "Shtëpi banimi (ndërtuar në vitet 2004 - 2006 në truallin në pronësi) me sip. 141 m<sup>2</sup>, me leje ndërtimi nr. \*\*\*, datë 13.4.2004, hipotekuar në ZVRPP-në Korçë me certifikatë pronësie me nr. pasurie \*\*\*, datë 20.6.2006. Është sqaruar se vlere e ndërtimit bazë është 4,600,000 lekë (sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 21.6.2004, të Zyrës së Urbanistikës, Bashkia Korçë), por janë kryer edhe punime shtesë ekstra në ambientet brenda shtëpisë, si dhe shpenzimet për mobilim, të cilat në total përbëjnë vlere e shtëpisë 7,000,000 lekë".
- Mund të deklaroni pse në deklaratën "Vetting" keni deklaruar "shtëpi banimi", kurse sipas lejes së ndërtimit dhe regjistrimit pranë ZVRPP-së kjo pasuri rezulton "shtëpi dhe dyqan". Mund të na vini në dispozicion dhe disa foto të jashtme të objektit të deklaruar "shtëpi banimi"?
- Mund të deklaroni nëse këtë pasuri e keni përdorur vetëm ju dhe familjarët tuaj, apo e keni dhënë në përdorim. Nëse e keni dhënë në përdorim, mund të dokumentoni përdorimin e saj dhe të ardhurat e krijuar nga ana juaj?
- Mund të deklaroni dhe dokumentoni sipërfaqen totale të ndërtimit të banesës dhe dyqanit?
- Mund të na vini në dispozicion një kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë ndërtues "\*\*\*", situacionet e punimeve, preventivin, vlere totale të shpenzuar për të gjitha punimet

<sup>1</sup> Shihni Udhëzimet Nr. 5, datë 4.3.2004, Nr. 5, datë 23.11.2005 dhe Nr. 5, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave për koston mesatare të ndërtimit.

*e ndërtimit (duke i ndarë sipas viteve respektive), si dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë ndërtuese “\*\*\*”?*

- *Mund të deklaroni dhe provoni punime shtesë ekstra në ambientet brenda shtëpisë, si dhe të deklaroni kush i ka kryer këto punime shtesë, sa është sipërfaqja e ndërtimit të shtesës, vlera respektive dhe viti i kryerjes së këtyre punimeve?*
- *Mund të na deklaroni vlerën e shpenzimeve të kryera për mobilimin e kësaj pasurie, duke i ndarë sipas viteve përkatëse për shpenzimet e kryera?*
- *Mund të sqaroni pse nuk keni deklaruar këtë pasuri dhe vlerën e investimit të kryer në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara pranë ILDKPKI-së për vitet 2003 dhe 2004?*
- *Mund të na vini në dispozicion një kopje të dokumentacionit provues lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie?*

Në përgjigje të pyetësorit subjekti i rivlerësimit deklaroi:

- *“Është e vërtetë se në lejen e ndërtimit rezulton ‘shtëpi me dyqan’ që i takon perspektivës, por për deklarimin si ‘shtëpi banimi’ i jam referuar certifikatës së pronësisë, lëshuar në datën 20.6.2006. Në kartelën e pasurisë dhe hartën treguese kjo pasuri nuk është regjistruar si ‘shtëpi me dyqan’.*
- *Kjo pasuri është përdorur vetëm nga unë dhe familja ime që nga fundi i muajit maj 2007 dhe aktualisht, dhe nuk është dhënë asnjëherë në përdorim.*
- *Sipërfaqja totale e ndërtimit të banesës është 141 m<sup>2</sup>.*
- *Ndërtimi i shtëpisë është bërë me leje ndërtimi, referuar praktikës së atëhershme të lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 13.4.2004. Sipas kontratës me shoqërinë ndërtuese ‘\*\*\*’, marrëveshja ka qenë për mbikëqyrjen dhe drejtimin teknik të punimeve, duke kryer vetëm punimet e themeleve dhe kolonave, ndërsa punimet e tjera ndërtimore janë kryer nga vetë investitori, dhe konkretisht nga bashkëshorti im A.Q., (me profesion teknik ndërtimi) bashkë me vëllain e tij dhe të afërm, si dhe me vëllain tim I.G. Vlera totale e shpenzuar për të gjitha punimet e ndërtimit (ku përfshihen edhe punimet ekstra brenda banesës dhe mobilimin) është në shumën 7,000,000 lekë, me burim krijimi dy depozitat bankare në Bankën e Kursimeve Korçë (sot ‘Raiffeisen Bank’) të krijuara me të ardhurat nga puna në emigracion e bashkëshortit, depozita bankare në emrin tim në Bankën e Kursimeve Korçë, sot ‘Raiffeisen Bank’ e krijuar me kursime nga paga ime dhe interesa bankare ndër vite nga këto depozita.*
- *Punimet shtesë ekstra në ambientet brenda shtëpisë nuk përfaqësojnë asnjë ndryshim të sipërfaqes së ndërtimit, por vetëm punime speciale në ambientin brenda shtëpisë, që lidhen me punime dekorative gipsi, kolona dhe tulla gipsi, dekorim oxhaku, patinime, lysterje etj., të cilat deklaroj me përgjegjësi të plotë se janë kryer pa kosto pune nga vëllai im I. G., i cili ishte i specializuar në këtë profesion. Këto punime janë kryer gjatë vitit 2005, si dhe pas muajit korrik të vitit 2006, pasi vëllai është shkëputur përfundimisht nga emigracioni në Greqi.*
- *Lidhur me mobilimin e shtëpisë deklaroj se është bërë në mënyrë të vazhdueshme në vitet 2005, 2006, 2007 dhe nuk mund ta përcaktoj me saktësi për shkak të periudhës së largët, por me një vlerë të përafërt rreth 1,200,000 lekë, (ku në vitin 2005 rreth 700,000 lekë, në vitin 2006 rreth 300,000 lekë dhe në vitin 2007 rreth 200,000 lekë).*
- *Ndërtimi i shtëpisë ka filluar në vitin 2004 pasi është nxjerrë leja e ndërtimit dhe ka vazhduar deri në vitin 2006. Për sa i përket deklarimit të kësaj pasurie dhe vlerës së investimit, sqaroj se pasaktësitë në deklaram lidhen më faktin se nuk kam qenë shumë e*

*qartë në plotësimin e deklaratave të para lidhur me deklarinin e momentit të fillimit të ndërtimit të shtëpisë dhe përfundimit të saj, apo momentin e regjistrimit të saj pranë ZVRPP-së Korçë dhe nuk kam pasur asnjë qëllim mosdeklarimi, pasi kjo është pasuria e vetme e paluajtshme që kam krijuar me bashkëshortin me të ardhurat e tij nga emigracioni, kursimet e mia nga paga dhe interesat bankare ndër vite.*

- *Sqaroj se për të vërtetuar shumën e të ardhurave të realizuara nga puna në emigracion e bashkëshortit, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi të kësaj pasurie, kam mundur të siguroj të dhënat për gjetjen e llogarisë bankare në Greqi të bashkëshortit në periudhën që ka qenë në emigracion. Këto të dhëna konfirmojnë faktin se në llogarinë bankare të bashkëshortit janë realizuar depozitime dhe tërheqje njëkohësisht të shumës 4,948,780.00 dhrahmi, si dhe konfirmime se arkivat e mandateve të viteve 1991 - 1997 janë asgjësuar për arsye se ka kaluar periudha 20-vjeçare dhe nuk ekzistojnë kopje të mandateve dhe ndërmjet tyre edhe transferta përkatëse.*
- *Për këto paraqes edhe prova përkatëse.”*

Lidhur me këtë pasuri Komisioni konstatoi se:

- Në deklaratën “Vetting” dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se vlera standarde e ndërtimit arrin në shumën 4,600,000 lekë për punimet e themelit dhe kolonës dhe se këto punime janë bërë nga shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k. Punime të tjera ndërtimi u kryen nga bashkëshorti, duke qenë teknik ndërtimi, vëllai i tij dhe të afërm të tjerë. Për më tepër, ishin kryer punimet e brendshme dhe mobilimi ishte blerë. Vlera e përgjithshme e kësaj pasurie arriti në shumën 7,000,000 lekë. Këto punime janë deklaruar se janë bërë nga subjekti në vitet 2004 - 2006, por investimet dhe vlerat përkatëse nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore të deklarinimit të pasurisë për vitet 2004 - 2006.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se nuk është në gjendje të përcaktonte se kur, saktësisht ndërmjet viteve 2004 dhe 2006, janë bërë punimet për ndërtimet e jashtme të shtëpisë së banimit. Për këtë subjekti i është referuar disa tërheqjeve të parave nga llogaritë bankare, për të cilat deklaroi se janë përdorur për të paguar kostot e ndërtimit. Ky deklarinim i subjektit nuk vërteton faktin për përdorimin e këtyre fondeve të tërhequra nga banka për qëllimet e pagesave të punimeve të kryera për këtë pasuri prej saj. Për këtë subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor shkresor provues të periudhës përkatëse, lidhur me përdorimin e këtyre fondeve.

- Subjekti i referohet një kontrate sipërmarrjeje me kompaninë “\*\*\*\*” sh.p.k., për ndërtimin e banesës me një vlerë të deklaruar prej 4,600,000 milionë lekësh. Për ta mbështetur këtë fakt subjekti ka paraqitur edhe një leje ndërtimi të dhënë nga KRRT-ja pranë Bashkisë Korçë. Por kjo leje ndërtimi nuk provon faktin e ndërtimit të objektit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Mungon dokumentacioni provues, kontrata e lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dokumentacion që provon punimet e kryera nga kjo shoqëri, vlerat përkatëse, faturat dhe të gjitha likuidimet financiare të bëra nga subjekti për këtë shoqëri ndërtuese.

- Subjekti ka deklaruar se ndërtimet dhe punimet e brendshme për pasurinë shtëpi banimi janë realizuar me kontributin e bashkëshortit dhe të vëllait të saj. Këto punime janë deklaruar se janë realizuar gjatë vitit 2005, si dhe pas korrikut të vitit 2006. Për këtë deklarinim subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues lidhur me kryerjen e këtyre punimeve dhe vlerat përkatëse të shpenzuara, si dhe që bashkëshorti dhe vëllai i saj kanë qenë specialistë të fushës së ndërtimit dhe nëse kanë pasur licencë përkatëse në ndërtim.

- Subjekti ka deklaruar se për sa i përket arredimit të banesës, ky arredim është bërë gjatë viteve 2005, 2006 dhe 2007, por pa vënë në dispozicion dokumentacion provues lidhur me vlerat e shpenzuara për arredimin e banesës në këto vite.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, nga subjekti nuk është saktësuar (mungon planimetria e objektit) dhe nuk del e qartë sipërfaqja e ndërtimit për të gjithë pasurinë shtëpi banimi.

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 subjekti ka deklaruar për herë të parë ndërtimin e objektit shtëpi banimi me vlerë 7,000,000 lekë, me pjesë takuese 50 %, në bashkëpronësi me bashkëshortin. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006 subjekti ka deklaruar përfundimin e objektit dhe ka ritheksuar se vlera e objektit të ndërtimit është në shumën 7,000,000 lekë, me pjesë takuese 100 % nga ana e saj.

Gjithashtu, lidhur me problematikat e konstatuar më sipër nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka deklaruar:

*“Në plotësimin e deklaratave të para të pasurisë nuk kam qenë shumë e qartë se duhej të pasqyroheshin në mënyrë analitike investimet (sipas zërave të punimeve) dhe vlerat përkatëse të shpenzuara sipas viteve, nisur nga fakti se kam konsideruar të mjaftueshme vetëm deklarinimin e pasurisë së paluajtshme shtëpi banimi (ndërtuar me leje ndërtimi sipas legjislacionit të kohës) dhe vlerën totale të investimit.*

*Ndërtimi i shtëpisë ka filluar pasi është nxjerrë leja e ndërtimit në qershor të vitit 2004, me vendim nr. \*\*\*, datë 13.4.2004, të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Korçë (lëshuar në datën 24.6.2004). Me menaxhimin e ndërtimit është marrë vetë bashkëshorti A. Q., i cili kryente dhe likuidimin cash të pagesave për materialet dhe punimet. Shpenzimet janë bërë të ndara për çdo zë sipas radhës së ndërtimit. Pikërisht për këtë arsye tërhiqej një pjesë fondi nga depozita bankare, që përdorej për blerjen pjesore të materialeve të ndërtimit sipas ecurisë së tyre dhe nevojave.*

*Aktualisht nuk disponojmë dokumentacion të periudhës përkatëse lidhur me shpenzimet për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, sepse nuk kam menduar gjatë asaj kohe se ishte e nevojshme mbajtja e çdo fature pikërisht për zëra ditorë të blerjes së materialeve gjatë ndërtimit.*

*Fondet e tërhequra në depozitat bankare janë fonde që kanë shërbyer si burim i vetëm i krijimit të kësaj pasurie të deklaruar dhe janë shpenzuar me qëllim ndërtimin e shtëpisë, përfshi edhe mobilimin, e cila është pasuria e vetme e paluajtshme që posedojmë me bashkëshortin deri më sot.*

*Sqaroj se në periudhat e tërheqjes se lekëve nga këto depozita bankare nuk kam kryer asnjë investim apo shpenzim tjetër me këto fonde, përveç ndërtimit të shtëpisë ku banoj, si dhe nuk kam pasur burim tjetër të ardhurash për ndërtimin, pasi nuk kam marrë kredi apo hua tek persona të tjerë, për të vënë në dyshim përdorimin e këtyre fondeve për kryerjen e pagesave në këtë investim. Konkretisht, paraqes të detajuar fondet që janë tërhequr nga depozitat bankare me destinacion këtë investim:*

- në datën 25.3.2004 tërhequr 1,103,126 lekë (nga depozita bankare nr. \*\*\* në emër të A.Q.;
- në datën 31.5.2004 tërhequr 1,059,527 lekë (nga depozita bankare nr. \*\*\* në emër të A.Q.;
- në datën 27.8.2004 tërhequr 699,660 lekë (nga depozita bankare nr. \*\*\* në emër të Rozeta Qirjaqi;
- në datën 28.9.2004 tërhequr 1,000,000 lekë (nga depozita bankare nr. \*\*\* në emër të A.Q.;

- në datën 28.6.2005 tërhequr 2,000,000 lekë (nga depozita bankare nr. \*\*\* në emër të A. Q.,;
- në datën 4.10.2005 tërhequr 743,978 lekë (nga depozita bankare nr. \*\*\* në emër të A. Q.,;
- në datën 5.4.2006 tërhequr 1,000,000 lekë (nga depozita bankare nr. \*\*\* në emër të A. Q.

Në lidhje me sa më sipër, ju sqaroj se krahas lejes së ndërtimit të lëshuar nga Bashkia Korçë janë përpiluar një sërë dokumentesh ligjore midis meje, në cilësinë e investitorit, dhe shoqërisë '\*\*\*' sh.p.k., në cilësinë e zbatuesit (mbikëqyrësit) të punimeve dhe konkretisht ju vë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji për urbanistikën në momentin e ndërtimit (praktika që ndodhet edhe në Zyrën e Urbanistikës Bashkia Korçë) për këtë investim:

- kontratë ndërtimi datë 10.6.2004, lidhur midis investitorit Rozeta Qirjaqi dhe shoqërisë së ndërtimit '\*\*\*';
- licencë nr. \*\*\*, datë 27.1.2003, e shoqërisë '\*\*\*', certifikatë regjistrimi në organin tatimor me NIPT \*\*\* dhe KODI Fiskal \*\*\*;
- vërtetim penaliteti për tërheqje leje ndërtimi datë 17.6.2004;
- vërtetim datë 21.6.2004, i Zyrës Përmbartimore Korçë, që konfirmon se shoqëria '\*\*\*' nuk ka detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, private apo shtetërore;
- vërtetim datë 22.6.2004, i Drejtorisë së të Ardhurave, Bashkia Korçë, se subjekti '\*\*\*' ka kryer pagesat lokale për vitin 2004;
- vërtetim datë 21.6.2004, i Prokurorisë së Rrethit Korçë, që konfirmon se shoqëria '\*\*\*' nuk është në ndjekje penale;
- vërtetim datë 21.6.2004, i Gjykatës së Rrethit Korçë, që konfirmon se shoqëria '\*\*\*' nuk rezulton të ketë proces gjyqësor;
- mandatarkëtim nr. \*\*\*, datë 21.6.2004, sipas origjinalit që ndodhet në dosje në Zyrën e Urbanistikës, Bashkia Korçë, për shlyerjen e detyrimit nga investitori të 2 % të vlerës së investimit në Zyrën e Tregti-Taksave, Bashkia Korçë;
- vendim nr. \*\*\*, datë 13.4.2004, i KRRT-së, Bashkia Korçë, për miratimin e sheshit të ndërtimit lëshuar në datën 24.6.2004;
- leje ndërtimi me vendim nr. \*\*\*, datë 13.4.2004, e KRRT-së, Bashkia Korçë, lëshuar në datën 24.6.2004;
- procesverbal datë 26.6.2004 për përfundimin e piketimit, sipas projektit të miratuar ndërmjet topografit S.B., dhe shoqërisë '\*\*\*';
- procesverbal për përfundimin e themeleve datë 3.7.2004, sipas projektit të miratuar ndërmjet topografit S.B., dhe shoqërisë '\*\*\*';
- certifikatë cilësie mbi analizën e cilësisë me aparat sklerometër, datë 15.7.2005, nr. \*\*\* e Laboratorit Fiziko-Mekanik i Ndërtimit Korçë, përpiluar nga përgjegjësi Th.D., ku betoni (tra, kolonë, soletë) plotëson kushtet teknike;
- certifikatë cilësie mbi analizën e cilësisë datë 15.7.2005, nr. \*\*\* e Laboratorit Fiziko-Mekanik i Ndërtimit Korçë, përpiluar nga përgjegjësi Th.D., ku përbërja granulometrike (granil) është brenda standardit;
- certifikatë cilësie mbi analizën e cilësisë datë 15.7.2005, nr. \*\*\* e Laboratorit Fiziko-Mekanik i Ndërtimit Korçë, përpiluar nga përgjegjësi Th.D., ku përbërja granulometrike (rërë e larë) është brenda standardit;
- certifikatë cilësie mbi analizën e llaçit datë 15.7.2005, nr. \*\*\* e Laboratorit Fiziko-Mekanik i Ndërtimit Korçë, përpiluar nga përgjegjësi Th.D., ku llaçi për punime muraturë dhe suvatimi është brenda standardit;
- preventiv i shoqërisë '\*\*\*' për zëra punimesh në vlerë 895,800 lekë;

- vërtetim datë 11.1.2006 i Degës së Tatim-Taksa Korçë, ku subjekti ‘\*\*\*’ paraqitet i shlyer me të gjitha detyrimet tatimore;
- procesverbal kolaudimi nr. \*\*\*, datë 20.1.2006, përpiluar nga kolaudatori ing. F. Th.;
- certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. \*\*\*, në emër të Rozeta Qirjaqi, lëshuar në datën 20.6.2006.

Sqaroj se likuidimi i shoqërisë ndërtuese për ato punime të kryera është bërë cash në arkën e shoqërisë, sipas zërave të punimeve të përcaktuar në preventivin përkatës që ndodhet në dokumentacionin e Zyrës së Urbanistikës, Bashkia Korçë. Aktualisht nuk i disponojmë faturat për likuidimet e pagesave, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, pasi nuk i kemi ruajtur. Dhe në zyrën e shoqërisë ndërtimore nuk janë ruajtur këto dokumente të veprimeve financiare, për shkak të kalimit të afatit 5-vjeçar të ruajtjes së dokumentacionit tatimor, si dhe për shkak se shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k. i ka kaluar kontrollet tatimore për periudhën kur është kryer ky investim, konfirmuar ky fakt dhe sipas vërtetimit për sqarim shlyerje detyrimi datë 28.4.2020 të shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k.

Aktualisht nuk disponoj dokumentacion tjetër provues lidhur me kryerjen e këtyre punimeve dhe vlerat e shpenzuara.

Në lidhje me kualifikimin në sektorin e ndërtimit të bashkëshortit A.Q., paraqes si prova dhe dëshmi kualifikimi dhe librezë punësimi. Për periudhën kohore kur është kryer ndërtimi i shtëpisë bashkëshorti dhe vëllai nuk kanë pasur licencë, sepse legjislacioni i kohës nuk kërkonte si kusht pajisjen me licencë për individët që kryejnë punime në shtëpinë e vet, pra për punimet që ka kryer vetë bashkëshorti në shtëpinë e tij, apo dhe nga vëllai im.

Lidhur me arredimin (mobilimin) e shtëpisë nuk disponoj aktualisht fatura lidhur me vlerat e shpenzuara për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

Referuar certifikatës së pronësisë lëshuar në datën 20.6.2006, kartelës së pasurisë lëshuar në datën 11.7.2019 dhe hartës treguese nga ZVRPP Korçë, si dhe referuar raportit për vlerësim pasurie datë 9.3.2020 dhe projektit të pronës, deklaroj se sipërfaqja për pasurinë shtëpi banimi \*\*\* e llojit truall + ndërtesë është 300 m<sup>2</sup> truall dhe nga kjo sipërfaqja e ndërtesës dykatëshe është 141 m<sup>2</sup>. Bashkëlidhur po ju vë në dispozicion dokumentet që disponoj.

Në lidhje me deklarinë e kësaj pasurie realisht kam deklaruar paraprakisht në bazë të Kodit të Familjes zotërimin në masën 50 % të shtëpisë në fillim të punimeve, duke qenë pasuri bashkëshortore dhe mandej duke qenë se mbas daljes së certifikatës së pronësisë vetëm në emrin tim nga ana e hipotekës, atëherë për të qenë korrekt me dokumentacionin e prodhuar nga organi shtetëror kam deklaruar pasurinë 100 % në emrin tim. Gjithsesi këtu kemi të bëjmë vetëm me deklarime bashkëshortore dhe pasuria e fituar gjatë martesës është e përbashkët midis bashkëshortëve, ku pavarësisht mënyrës së deklarimit tim nuk ka shtim apo pakësim të pasurisë bashkëshortore në të.

Për sa i përket deklarimeve të investimit 7 milionë lekë në fillim dhe në fund të periudhës së ndërtimit, ju sqaroj se kjo ishte shuma që ne kishim llogaritur të investonim nga buxheti i familjes për ndërtimin e kësaj banese. Dhe rrjedhimisht kjo shumë u deklarua në fund të periudhës së ndërtimit, për faktin se me mbarimin e kësaj shume unë nuk vazhdova më me investimin dhe nëse vëzhgoni me imtësi fotot e banesës ose këqyret banesa nga afër ka shumë punime që mungojnë dhe që mund të realizoheshin në këtë banese, por që për shkak të mbarimit të buxhetit të projektuar për këtë qëllim nuk kanë mundur të realizohen. Pra, kjo vlerë totale e

*investimit është vendosur që në fillim për ndërtimin dhe ky është shpenzimi real për këtë ndërtim, pavarësisht mënyrës kronologjike të deklarimit të këtij ndërtimi.”*

### **Analiza financiare e bërë nga Komisioni lidhur me mundësitë e ndërtimit të banesës në vitet 2004 – 2007 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

Të ardhura A.Q.,	0
Depozita Rozeta Qirjaqi “Raiffeisen Bank”, tërhequr më 27.8.2004	699 660
Kosto ndërtimi banese me sip. 282 m <sup>2</sup> sipas EKB-së	6 991 720
Kosto punime shtesë	1 200 000
Kosto arredimi	1 200 000
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-8 692 060</b>

Në analizën financiare nuk janë marrë parasysh nga Komisioni gjendjet e depozitave bankare të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”, për shkak se subjekti nuk ka arritur të vërtetojë burimin e të ardhurave të krijuara në shtetin grek.

Gjithashtu, në analizën financiare u përfshinë edhe shpenzimet e deklaruara nga subjekti për kosto ekstra të punimeve të kryera dhe shpenzimet e arredimit, të nxjerra këto si rezultat i diferencës së vlerës së përgjithshme që ka deklaruar se ka shpenzuar për krijimin e kësaj pasurie dhe koston e ndërtimit të deklaruar nga subjekti (7,000,000 lekë – 4,600,000 lekë = 2,400,000 lekë).

Për koston e ndërtimit të kësaj pasurie dhe të llogaritur në analizën financiare, Komisioni u bazua në çmimet mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave për vitet 2004 - 2006 dhe në sipërfaqen totale të llogaritur  $141 \text{ m}^2 \times 2 = 282 \text{ m}^2$ . Bazuar në planimetritë e paraqitura nga subjekti rezultoi se sipërfaqja totale e ndërtimit të këtij objekti dykatësh është  $141 \text{ m}^2$ , për çdo kat ( $141 + 141 = 282$ ).

### **Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit**

Referuar deklaratës “Vetting”, pyetësorëve të dërguar nga subjekti dhe dokumentacionit të paraqitur dhe administruar gjatë hetimit të kryer, Komisioni arriti në përfundimin se:

- Subjekti ka mungesë dokumentacioni të plotë justifikues ligjor për vlerën e plotë të investuar në ndërtimin, si dhe për mobilimin e shtëpisë së banimit (mungesë të preventivit, situacion punimesh, aktkolaudimi, fatura likuiduese, etj.).
- Subjekti ka mosdeklarim të investimeve në ndërtimin e shtëpisë së banimit në deklarimin e interesave private periodike vjetore 2004, pasi për herë të parë ndërtimin e banesës subjekti e deklaroi në vitin 2005. Gjithashtu, subjekti në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2006 nuk ka deklaruar ndryshimin e likuidideteve në bankë, të cilat sipas subjektit kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.
- Subjekti nuk ka deklaruar saktë sipërfaqen totale të ndërtimit të shtëpisë së banimit. Kjo sipërfaqe është deklaruar nga subjekti si sipërfaqe prej  $141 \text{ m}^2$ . Subjekti nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë provues lidhur me sipërfaqen e përgjithshme të ndërtimit. Sipërfaqja totale e objektit dykatësh është  $282 \text{ m}^2$  dhe vlera e llogaritur nga Komisioni për ndërtimin, bazuar në çmimet mesatare të ndërtimit për vitet 2004 - 2006, është në shumën prej 6,991,720 lekësh.
- Sipas vendimit të KRRT-së Korçë dhe lejes së shfrytëzimit objekti i ndërtimit është “banesë me dyqan” dhe jo vetëm banesë, siç është deklaruar nga subjekti.

- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë provues lidhur me burimin e ligjshëm të ardhurave<sup>2</sup> që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me pakësimin e depozitës në “Raiffeisen Bank”, me qëllim investimin në ndërtimin e objektit shtëpi banimi, në deklaramet e interesave private “para fillimit në detyrë 2003” deri në deklaramtën periodike vjetore të vitit 2006.
- Subjekti ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën -8,692,060 lekë.

Për konstatimet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës, për të dhënë argumentet dhe provat e saj në lidhje me gjetjet e bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

### **Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti paraqiti dhe deklaroi:**

*“Për sa i takon dokumentacionit për ndërtimin e shtëpisë ritheksoj se shtëpinë e kam ndërtuar me leje ndërtimi (me vendim nr. \*\*\*, datë 13.4.2004, të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Korçë, lëshuar në datën 24.6.2004) dhe nuk është një objekt informal. Për këtë qëllim kam tërhequr të gjithë dokumentacionin që ndodhet në dosjen e praktikës përkatëse në Zyrën e Urbanistikës pranë Bashkisë Korçë. Ky dokumentacion është përpiluar sipas rregullave të legjislacionit në fuqi të ndërtimit të pranuar nga ky institucion kompetent, duke shlyer pagesën e detyrimeve të taksave përkatëse dhe nuk më është kërkuar ndonjë dokument shtesë për vlerën e plotë të investimit. Mbi bazën e aktit të kolaudimit datë 20.1.2006, Bashkia Korçë ka lëshuar lejen e shfrytëzimit nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2006 dhe si institucion kompetent ka dërguar lejen e shfrytëzimit të objektit banesë me dyqan 2 kate dhe gjithë dokumentacionin përkatës pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë me qëllim regjistrimin e pasurisë.*

*Paraqes si prova shtesë:*

- shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2006, të Bashkisë Korçë, drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë;
- lejen e shfrytëzimit nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2006;
- mandatarkëtimin për leje shfrytëzimi nr. \*\*\*, datë 6.3.2006;
- procesverbal kolaudimi nr. \*\*\*, datë 20.1.2006.

*Në lidhje me deklaramin e sipërfaqes së banesës dhe emërtimit të pronës ‘shtëpi banimi’ apo ‘banesë me dyqan’ i jam referuar certifikatës së pronësisë, lëshuar në datën 20.6.2006 nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, ku nuk janë pasqyruar numri i kateve apo dhe cilësimi i katit të parë si dyqan. Edhe në dokumentet kartela e pasurisë dhe harta treguese, lëshuar në datën 11.7.2019 nga ZVRPP Korçë, pasqyrohet i njëjti fakt. Për më tepër dhe në lejen e ndërtimit sipërfaqja e banesës është pasqyruar 141 m<sup>2</sup>. Nga ana ime nuk ka dashje për të dokumentuar të dhëna të rreme ose të pasakta, për sa kohë që ju kam vënë në dispozicion të gjithë praktikën e lejes së ndërtimit ku pasqyrohen sipërfaqja, si dhe numri i kateve.*

*Lidhur me pasaktësitë në deklaramet, si për sa i përket periudhës së deklaramit të kësaj pasurie dhe ndryshimit të likuiditeteve, ritheksoj faktin se lidhen vetëm me deklaramin e momentit të fillimit të ndërtimit të shtëpisë dhe përfundimit të saj, apo momentin e regjistrimit të saj pranë ZVRPP-së Korçë dhe pajisjen me certifikatën e pronësisë (si veprim që përfundimisht të cilëson pronar). Ndërsa, në lidhje me ndryshimin e likuiditeteve që janë përdorur për këtë investim i jam referuar vetëm burimit të krijimit të pasurisë, duke deklaruar pakësim të depozitës në total,*

<sup>2</sup> Shihni në vijim lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit.



nisur dhe nga fakti që nuk kam pasur burim tjetër të ardhurash përveç këtyre depozitave bankare, të cilat do të përdoreshin vetëm me qëllim ndërtimin e pasurisë shtëpi banimi, pasi kjo është pasuria e vetme e paluajtshme që kam krijuar me bashkëshortin dhe posedojmë aktualisht, si dhe këto likuiditete nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër.

Në analizën financiare të mundësisë së ndërtimit të banesës për vitet 2004 - 2007 (f. 12) të ardhurat e bashkëshortit A.Q., janë marrë në vlerën 0 lekë. Ndërkohë që nuk është marrë parasysh depozita bankare e hapur në datën 2.2.1998, sipas kartelës depozitë kursimi në Bankën e Kursimeve Korçë, që prej periudhës shkurt 1998 deri në vitin 2003, e cila përfaqëson principalin, si dhe shtesat nga interesat bankare. Kjo depozitë ka ardhur nga transferimi i parave të depozituara nga bashkëshorti në Bankën Kombëtare të Greqisë nga puna gjatë periudhës së emigracionit dhe në fakt ky është një rast i rrallë për kushtet e kohës, pasi që në fillim të periudhës së emigracionit, pra në tetor të vitit 1991, bashkëshorti A.Q., ka hapur llogari kursimi në shtetin grek duke depozituar në bankë të ardhurat nga puna e tij në shtetin grek (periudhë në të cilën ka qenë beqar).

Referuar provave dokument: kërkesës për hapje llogarie bankare datë 15.10.1991, në emër të A.Q., sipas origjinalit në arkiv në Bankën Kombëtare të Greqisë, dega e Bankës Arnea, si dhe vërtetimeve të Bankës Kombëtare të Greqisë, legalizuar me vulë apostile, provohet jo vetëm fakti i hapjes së llogarisë bankare në emër të A.Q., me nr. \*\*\* që në tetor të vitit 1991, por edhe depozitime dhe tërheqje të shumës 4,948,780.00 dhrahmi, si dhe pamundësia objektive për të siguruar informacion më të plotë për shkak të kalimit të periudhës 20-vjeçare të ruajtjes së dokumenteve. Pra, në lidhje me këto dokumente provoj faktin se këto të ardhura me burim nga emigracioni janë fituar në periudhën kohore 1991 - 1997 dhe kanë lidhje kronologjike me periudhën kohore kur janë futur në sistemin bankar në Shqipëri, duke qenë burim krijimi për depozitat e bashkëshortit në Bankën e Kursimeve Korçë.

Gjithashtu, theksoj faktin që bashkëshorti A.Q., ka punuar në Selanik të shtetit grek gjatë vitit 1998 në firmën e ndërtimit me pronar M.R., duke paguar detyrimet dhe ka përfunduar sigurime shoqërore në IKA, por sqaroj se bashkëshorti ka aplikuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore Selanik për gjetjen e dokumentacionit të sigurimeve shoqërore në shtetin grek për këtë periudhë punësimi, duke e konfirmuar me dokumentin vërtetim aplikimi datë 21.2.2020, në emër të A.Q., në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve Selanik, drejtuar Drejtorisë së Informacionit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Selanik.

Për shkak të situatës së pandemisë së krijuar nga COVID-19 jam në pamundësi objektive për disponimin dhe paraqitjen si provë para jush të këtij dokumentacioni lidhur me punësimin në këtë periudhë, kjo për shkak të mbylljes së kufirit me shtetin grek dhe duke e vlerësuar si një shkak të arsyeshëm kërkoj të më jepet kohë nga ana juaj për të mundësuar sigurimin e dokumenteve.

Sipas tabelës së hartuar nga ju, analiza financiare (f. 28), janë shënuar interesat nga kjo depozitë për periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2007, ndryshe nga analiza në tabelën (f. 12) ku të ardhurat janë 0.

Gjithashtu, edhe analiza financiare në faqen 28 nuk ka marrë parasysh burimin nga kanë ardhur interesat e pasqyruara nga ju në vitet e mëvonshme.

Kostot e punimeve shtesë në vlerën 1,200,000 lekë nuk janë kryer pas mbarimit të ndërtimeve, por janë kryer midis periudhës së marrjes së lejes së ndërtimit dhe lejes së shfrytëzimit të

ndërtesës dhe janë përfshirë në kostot e ndërtimit. Ka një keqkuptim për sa i takon punimeve shtesë, pasi në kategorinë e tyre klasifikohen si punime gipsi, tullë xhami, kolona, dekorim oxhaku, patinime, etj., si dhe në kostot e ndërtimit nuk përfshihen vetëm hedhja e betonit apo ndërtimi i mureve, por edhe punimet e brendshme. Në deklaratën 'Vetting' vetëm i kam ndarë llojet e punimeve, por nuk janë kosto shtesë, pasi një shtëpi ka dhe ndarje muresh të brendshme që hyjnë në koston e ndërtimit.

Kostoja e ndërtimit nuk ka shkuar sa kostoja e Entit të Banesave, por vlera e të gjithë ndërtimit së bashku me mobilimin është 7,000,000 lekë (për faktin se dhe shumë punime janë kryer nga vetë bashkëshorti dhe vëllai im, fakt që e konfirmoj me provat/dëshmi deklaratat noteriale të komshinjve A.B., dhe F.L.). Bashkëngjitur paraqes si provë dhe aktin e raportit vlerësim pasurie, datë 9.3.2020, i cili duhet të trajtohet si provë nga ana juaj në cilësinë e aktit të ekspertimit (referuar dhe qëndrimin në vendimin nr. 34, datë 19.2.2009, të Gjykatës së Lartë).

Gjithashtu, dua të theksoj se kati i parë i ndërtesës nuk është kat banimi, por aktualisht shërben si depo (magazinë) për nevoja të familjes dhe kostoja e ndërtimit të këtij kati nuk mund të jetë e njëjtë me atë të ndërtimit si banesë. Ky fakt konfirmohet nga fotot e banesës dhe të katit të parë, por edhe nga raporti i vlerësimit të pasurisë, datë 9.3.2020 nga ekspert i licencuar.

Në analizën financiare (sipas f. 28) vlera 7,639,865 e shënuar në likuiditete, në të ardhurat e dokumentuara, nuk është pasqyruar kjo shumë.

Mosmarrja parasysh e gjendjes së depozitave në vlerën 7,773,863.11 lekë, si dhe dublimi i koston për punime shtesë në vlerën 1,200,000 lekë mbulojnë diferencën e dalë nga ju.

Në analizën financiare, në pjesën e pasurisë, është shënuar si pasuri edhe vlera e depozitës para vitit 2003 në shumën 7,639,865 lekë. Ky likuiditet në vitet 2004, 2005, 2006 është shndërruar në shtëpinë e banimit dhe nuk mund të jetë më si pasuri në gjendjen në fund.

Po në tabelën e analizës financiare në faqen 28, në 'pjesa e të ardhurave' nuk janë mbledhur të ardhurat para vitit 2003 në vlerën 2,834,023 lekë dhe totali i të ardhurave për Rozeta Qirjaqi duhet 20,290,264 lekë.

Po ashtu, nuk është përfshirë në të ardhurat gjendja e depozitave bankare në emër të A.Q., para vitit 2003, ndërkohë janë konsideruar si të ardhura interesat e llogaritura nga vitet e mëvonshme. Mbi cilën bazë janë marrë këto interesa kur nuk merret gjendja në depozitë?

Për sa i takon pjesës së shpenzimeve përpara vitit 2003 janë përfshirë si shpenzime, ndërkohë nuk janë llogaritur të ardhurat, prandaj del që kam pasur vetëm shpenzime deri në vitin 2003 dhe asnjë të ardhur.

Për diferencat e nxjerra në vitin 2005 në vlerën -829,814 lekë nuk e di se ku është mbështetur llogaritja e vlerës së ndërtimit 3,226,948 lekë kur mungon dokumentacioni dhe nuk është askund e shënuar se sa ka qenë vlera e ndërtimit në këtë vit.

Në shpenzimet e atij viti janë përfshirë edhe shtesat për arredim, si dhe shpenzimet për shtesa punimesh, pra, janë dubluar vlera 1,300,000 lekë dhe në shpenzim dhe në vlerën e shtëpisë së banimit.

Po ashtu, edhe për diferencat e nxjerra në vitin 2006 në vlerën -988,201 lekë përsëri është vendosur si vlerë ndërtimi 1,613,474 lekë kur mungon dokumentacioni dhe nuk është askund e shënuar sa ka qenë vlera e ndërtimit në këtë vit.

*Shpërndarja e shpenzimeve për ndërtesën është e gabuar, sepse shpenzimi më i madh është kryer në vitin 2004 dhe jo në vitet 2005 dhe 2006, fakt që duket qartë dhe në tërheqjet që janë kryer nga banka gjatë këtij viti.”*

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti nuk arriti të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni dhe as të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së krijuar.

Në analizën financiare, Komisioni mori parasysh tërheqjet nga depozitat bankare të subjektit dhe bashkëshortit në vitet 2004 – 2006, duke shpërndarë koston e ndërtimit të llogaritur sipas çmimit të EKB-së dhe sipërfaqes së ndërtimit, sipas përqindjes që zënë tërheqjet e secilit vit në totalin e tërheqjes nga depozitat që kanë shërbyer si burim i ndërtimit të pasurisë.

Bazuar në analizën financiare, edhe nëse do të merreshin parasysh nga Komisioni të gjitha të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit të subjektit nga emigracioni, rezultoi se subjekti ka përsëri pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2007 në vlerën prej - 1,269,887 lekësh.

### **Në përfundim Komisioni vlerëson se:**

1. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë sipërfaqen e kësaj pasurie dhe nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në pronësi dhe posedim të tij, pasi nga procesi i rivlerësimit rezultoi se subjekti ka në pronësi dhe posedon një objekt 2-katësh me sip. 282 m<sup>2</sup>, përfshirë edhe njësi/dyqan, ndërkohë që subjekti në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 deklaroi shtëpi banimi me sip. 141 m<sup>2</sup>.

2. Pretendimi i subjektit se ka deklaruar banesën sipas certifikatës së pronësisë nuk qëndron. Referuar udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i dalë në zbatim të nenit D, të ligjit nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 30, 31, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet qartë se subjekti i rivlerësimit në deklarimin e pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerje, kontratë sipërmarrje, akt marrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porosie etj, dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP.

3. Referuar Nenit D, pika 1, e Aneksit të Kushtetutës: “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur...” dhe më tej pika 5 parashikon se: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

4. Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri nuk ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, për pasojë kjo përbën shkak për masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

5. Komisioni më tej çmon se referuara praktikës së vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke qenë se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues vlerën e ndërtimit të këtij objekti, si kosto e ndërtimit merret çmimi mesatar i ndërtimit për vitet 2004 - 2006. Nga analizimi i pasurive, shpenzimeve dhe detyrimeve, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën prej – 8,692,060 lekë.

6. Si konkluzion të sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- i. është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim të tij në deklaratën “Vetting” dhe deklaratat periodike vjetore për vitet respektive;
- ii. ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë pasuri sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### **3. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit**

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të ardhura të krijuara nga puna në emigracion e bashkëshortit për periudhën 1991 – 1999 në shtetin grek. Vlera e deklaruar e këtyre të ardhurave është në shumën 12,000,000 GRD (dhrakmi greke).

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit për të provuar dhe dokumentuar të ardhura nga bashkëshorti i saj nga puna në emigracion në vlerën prej 12,000,000 dhrakmi.

Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka deklaruar:

*“Sqaroj se bashkëshorti A.Q., në vitet 1991 - 1999 ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek. Ai ka shkuar në emigracion që kur ka qenë beqar dhe ka punuar në vende të ndryshme Janoras-Mal të Shenjtë-Selanik, në Erithres-Thiva-Athinë dhe në Selanik të Greqisë. Për vetë kushtet e kohës së emigracionit në atë periudhë puna ka qenë informale, kjo dhe në kushtet kur vetë legjislacioni grek për emigrantët nuk ka rregulluar statusin e tyre deri në vitet 2001 - 2002, ku vetëm në vitin 1998 kanë dalë ligjet e para që rregullojnë lejen e qëndrimit për emigrantët. Në vitin 2001 ka dalë për herë të parë ligji që rregullon lejen e punës për emigrantët dhe deri në këtë vit ka pasur vakum ligjor për sa i përket kontributeve sociale, në kushtet kur vetë shteti grek ka qenë në pamundësi të kontrollonte flukset e emigrimit nga Shqipëria, jo vetëm në periudhën e emigrimit të tyre, por dhe vite më vonë, për t’u rregulluar me akte ligjore, të cilat nisën të zbatoheshin pas vitit 2002. (Për këto fakte referohem tek materiali i prezantuar përpara Forumit për Popullsinë Evropiane, në datë 12 - 14 janar 2004 me temë “Immigration into Greece 1990 - 2003” në anglisht f. 3,4,6,7,9).*

*Bashkëshorti, duke kryer punë të ndryshme kryesisht në ndërtimin apo meremetimin e banesave private të shtetasve të ndryshëm grekë, ka mbledhur kursime nga puna në atë periudhë, të cilat i ka depozituar në vazhdimësi në llogari bankare dhe depozitë kursimi në territorin grek, në bankë shtetërore (Bankën Kombëtare të Greqisë), llogari të cilën e ka hapur në tetor të vitit 1991 në Jerisso-Kalkidhiqi. Nga puna në Erithres-Thiva-Athinë ka vazhduar të depozitohet kursime dhe e ka mbyllur depozitën në shkurt të vitit 1997, ku ka tërhequr shumën prej rreth 8,000,000 (tetë milionë) dhrakmi greke në degën qendrore të kësaj banke në Selanik-Greqi. Këtë sasi të ardhurash për kushtet e kohës së emigracionit i ka sjellë cash nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Kapshticë. Pas konvertimit në lekë bashkëshorti ka hapur depozitë në Bankën e Kursimeve Korçë në shkurt të vitit 1998. Pjesën tjetër të të ardhurave bashkëshorti i ka sjellë*

cash në mënyrë periodike nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Kapshticë dhe i ka depozituar pas konvertimit në lekë në depozitë kursimi në Bankën e Kursimeve Korçë (sot 'Raiffeisen Bank') rreth viteve 2000 - 2001. Këto depozita janë shtuar për disa vjet nga interesat bankare (të cilat kanë qenë tepër të larta në atë periudhë kohore) dhe janë përdorur me qëllimin e vetëm për ndërtimin e shtëpisë ku aktualisht banoj. Sqaroj se këto dy depozita janë të pakësuara totalisht dhe janë të mbyllura në vitet 2004 - 2006.

Sqaroj se nuk disponojmë dokumentacion të këtyre viteve të llojit pasaportë shqiptare në kushtet kur sipas legjislacionit të kohës, me daljen e pasaportave të reja, pasaportat e vjetra dorëzoheshin dhe e kemi të pamundur objektivisht për të vërtetuar lëvizjet apo qëndrimin dhe punësimin në Greqi të bashkëshortit në vitet 1991 - 1999, por disponojmë dokumente të tjera, si: "libër shëndeti fëmije" të vajzës P.Q., e datëlindjes 7.7.1994, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë në Greqi, ku rezulton se ka lindur në Athinë dhe i janë kryer vaksinat deri në mars të vitit 1995, certifikata e lindjes së vajzës me vendlindje Athinë, Greqi, deklaratë me përgjegjësi të shtetasës grekë E.P., datë 14.3.2019, me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 28.3.2019, e cila konfirmon qëndrimin dhe indirekt punësimin e bashkëshortit në Greqi si emigrant ekonomik.

Po kështu, për të vërtetuar shumën e të ardhurave të realizuara nga puna në emigracion dhe gjetjen e llogarisë dhe depozitës bankare në Greqi, bashkëshorti A.Q., ka bërë kërkesa për gjetjen e llogarisë bankare në ato vite, nëpërmjet av. grek A.K.B., me zyrë në qytetin e Korçës, me NIPT \*\*\*, duke mundur të sigurojë të dhënat bankare, si më poshtë:

- Kërkesë për hapje llogarie bankare datë 15.10.1991, në emër të A.Q., sipas origjinalit në arkiv në Bankën Kombëtare të Greqisë, dega e Bankës Arnea, kodi \*\*\* (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), ku konfirmon faktin e hapjes së llogarisë bankare nga bashkëshorti pikërisht në tetor të vitit 1991 në degën e Bankës Jerisso, në vitin 1991.
- Vërtetim datë 8.6.2018, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Kostur (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon gjetjen e llogarisë bankare në emër të A.Q., me nr. \*\*\* dhe gjendjen e lëvizjeve të llogarisë bankare, për sa ishte e mundur, siç rezultuan nga verifikimi në arkivën e bankës.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2019, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega e Bankës Arnea (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon faktin se në llogarinë bankare të bashkëshortit janë realizuar depozitime dhe tërheqje njëkohësisht të shumës 4,948,780.00 dhrahmi, si dhe nuk është e mundur dhënia e kopjeve të mandateve të depozitimit dhe tërheqjes së të hollave të llogarisë.
- Vërtetim datë 10.6.2019, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Kostur (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon se arkivat e mandateve të viteve 1991 - 1997 janë asgjësuar për arsye se ka kaluar periudha 20-vjeçare dhe nuk ekzistojnë kopje të mandateve dhe ndërmjet tyre edhe transferta e shumës 2,500,000.00 dhrahmi e kryer në datën 22.6.1994.
- Vërtetim datë 26.6.2019, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Kostur (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon pamundësinë për gjetjen e veprimeve të tjera të kryera në llogarinë e bashkëshortit për arsye se ka kaluar periudha 20-vjeçare.

Sqaroj se këto veprime të tjera bankare kanë të bëjnë me mbylljen në depozitë të gjendjes së llogarisë bankare, me interes për periudha të caktuara 6-mujore, apo dhe më shumë, duke përfutur interes më të lartë bankar, që do të thotë se në pasqyrimin e shumës që konfirmon banka si të depozituar dhe të tërhequr 4,948,780.00 dhrahmi greke nuk janë llogaritur interesat

bankare ndër vite, të cilat e çojnë gjendjen e depozitës në mbyllje të saj në vlerën 8,000,000 dhrahmi, por për interesat bankare ndër vite jemi në kushtet e pamundësisë së gjetjes dhe përlllogaritjes së tyre për shkak të kalimit të afatit të ruajtjes. Gjithsesi, sipas këtyre provave vërtetohet faktin se këto të ardhura me burim nga emigracioni janë fituar në periudhën kohore 1991 - 1997 dhe kanë lidhje kronologjike me periudhën kohore kur janë futur në sistemin bankar në Shqipëri, duke qenë burim krijimi për depozitat e bashkëshortit në Bankën e Kursimeve Korçë (sot 'Raiffeisen Bank').

Sipas kartelës depozitë kursimi të Bankës së Kursimeve Korçë (sot 'Raiffeisen Bank') sqarohet se në datën 2.2.1998 bashkëshorti A.S.Q., ka hapur depozitë kursimi me afat, duke depozituar të ardhurat që ka sjellë nga emigracioni në shumën 3,000,000 lekë, ku si rrjedhojë e interesave të larta në datën 24.9.2002 kjo depozitë ka arritur shumën 5,522,978 lekë. Në këtë datë kanë kaluar në sistem në Bankën e Kursimeve Korçë me nr. \*\*\* të llogarisë bankare. Në vitin 2004 Banka e Kursimeve u kthye në 'Raiffeisen Bank' dhe kjo depozitë bankare referuar statementeve bankare, në datën 25.3.2004 nga interesat ka arritur në shumën 6,103,126 lekë. Kjo shumë është bërë veprim tërheqje brenda arkës, meqenëse kjo depozitë ka kaluar në sistem kompjuterik të 'Raiffeisen Bank', dega Korçë duke bërë bashkëshorti po në datën 25.3.2004 veprim nga kjo depozitë bankare derdhje cash, me xhirim në depozitë (nga arka) shumën 5,000,000 lekë, ndërsa shumën 1,103,126 lekë e ka tërhequr me qëllim fillimin e ndërtimit të shtëpisë. Nga kjo depozitë ka bërë tërheqje po në datën 28.9.2004 në shumën 1,000,000 lekë, me qëllim ndërtimin e shtëpisë, duke ngelur gjendje në llogari shuma 4,110,744 lekë, e cila ka vazhduar si depozitë e re me afat. Kjo depozitë nga interesat bankare në datën 28.6.2005 ka arritur shumën 4,230,838 lekë. Në datën 28.6.2005 është bërë tërheqje nga kjo depozitë në shumën 2,000,000 lekë (me qëllim vazhdimin e ndërtimit të shtëpisë) dhe pjesa e ngelur me veprim brenda bankës është çelur depozitë e re me afat tremujor në vlerën 2,230,838 lekë. Në datën 28.9.2005 nga interesat kjo depozitë ka qenë gjendje në shumën 2,243,696 lekë (duke lënë të hapur pa afat për arsye tërheqje për shkak të ndërtimit të shtëpisë). Në datën 4.10.2005 kjo depozitë në shumën 2,243,978 lekë është tërhequr me veprim brenda bankës dhe nga kjo depozitë një pjesë e lekëve ka kaluar me afat tremujor, duke bërë kalim derdhje depozite shumën 1,500,000 lekë dhe duke tërhequr diferencat në shumën 743,978 për ndërtimin e shtëpisë. Në datën 5.4.2006 ka bërë tërheqje të shumës 1,000,000 lekë (me destinacion ndërtimin e shtëpisë), duke ngelur në depozitë po me afat tremujor shuma 508,334 lekë. Në datën 3.11.2006 bashkëshorti ka mbyllur përfundimisht depozitën me nr. llogarie \*\*\* në shumën 510,972 lekë. Këtë shumë, pasi e ka konvertuar në dollarë amerikanë, bashkëshorti e ka depozituar në Bankën Amerikane (sot 'Intesa San Paolo Bank'), duke çelur depozitë në emrin e tij në datën 10.11.2006 në shumën 5,000 dollarë amerikanë.

Sipas inventarit për depozita kursimi me afat 3 muaj, datë 31.12.2001, të Bankës së Kursimeve, dega Korçë, Agjencia nr. 1, është çelur depozitë kursimi në emër të bashkëshortit A.Q., me burim krijimi të ardhurat nga emigracioni, me nr. libezeze \*\*\*, ku në datën 31.12.2001 gjendja në këtë depozitë ka qenë 1,393,021 lekë. Në vitin 2002 kanë kaluar në sistem në Bankën e Kursimeve Korçë me nr. \*\*\* të llogarisë bankare, ku në datën 19.11.2002, së bashku me interesat bankare, gjendja në depozitë ka qenë në shumën 1,484,271 lekë. Kjo depozitë, referuar statement-it bankar për lëvizje llogarie datë 18.3.2016 të 'Raiffeisen Bank', dega Korçë, është mbyllur në datën 31.5.2004, duke tërhequr bashkëshorti shumën 1,059,527 lekë, me destinacion ndërtimin e shtëpisë.

Konfirmoj këto rrethana me: deklaratë me përgjegjësi të shtetases greke E.P., datë 14.3.2019, me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 28.3.2019; 'libër shëndeti fëmije' të vajzës P.Q., e datëlindjes

7.7.1994, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë në Greqi; certifikata personale e lindjes së vajzës; kërkesë për hapje llogarie bankare e bashkëshortit A.Q., në Bankën Kombëtare të Greqisë, dega Jerisso Greqi, në datën 15.10.1991, konfirmuar dhe nxjerrë nga arkivi i Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Arnea Greqi, origjinali i kërkesës, legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020; katër vërtetime bankare të Bankës Kombëtare të Greqisë, Dega Kostur dhe Dega e Bankës Arnea, legalizuar me vulë apostile të argumentuar hollësisht më sipër; përmbledhje mandatpagesash në degët e Bankës Kombëtare të Greqisë për gjetjen e llogarisë bankare të A.S.Q., para viteve 2000; përmbledhje e përmbajtjes së autorizimeve të A.S.Q.; kartelë depozitë kursimi e Bankës së Kursimeve, çelur në datën 2.2.1998, deri në datën 24.9.2002, në emër të A.S.Q., (4 fletë); inventar për depozita kursimi me afat, datë 31.12.2001, të llogarisë në emër të A.Q., (1 fletë); lëvizje llogarie bankare nr. \*\*\*, në emër të A.S.Q., në statement-et bankare të lëshuar nga 'Raiffeisen Bank' (12 fletë); statement bankar datë 16.4.2008 të Amerikan Bank (sot 'Intesa San Paolo Bank') dhe datë 3.3.2010; inventar për depozita kursimi me afat datë 31.12.2001, të llogarisë në emër të A.Q., me nr. libeze \*\*\*, (1 fletë); statement bankar për lëvizje llogarie datë 18.3.2016, të 'Raiffeisen Bank', dega Korçë, për llogarinë nr. \*\*\*, në emër të A.Q., (2 fletë)."

Lidhur me këto të ardhura të deklaruar nga subjekti u konstatuan se:

Në përgjigje të pyetëtorit nr. 2 subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor shterues për të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj në emigracion për periudhën 1991 - 1999. Në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar të ardhurat nga emigracioni në shumën 12,000,000 dhrahmi greke. Kjo shumë është deklaruar se është sjellë dorazi në vitin 1997, si dhe "para të tjera" më vonë nëpërmjet kufirit së Shqipërisë nga bashkëshorti i saj, të cilat janë shkëmbyer në vlerën 7,000,000 lekë dhe të depozituara gjatë periudhës 1998 - 1999 në dy depozita në Bankën e Kursimeve Korçë (sot "Raiffeisen Bank").

Bazuar në konfirmimin e depozitave të "Raiffeisen Bank" rezultoi se në datën 31.12.2003 gjendja e depozitës arriti në shumën 6,029,805 lekë, në datën 31.12.2004 në shumën 4,152,861 lekë dhe më 31.12.2006 gjendja ishte 0 lekë.

Rezultoi se subjekti nuk e ka pasqyruar saktë ndryshimin e këtyre depozitave në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, si më poshtë vijon:

- ka pasaktësi në lidhje me uljen e depozitave bankare në DPV-të;
- në DPV-në e vitin 2004 subjekti nuk ka pasqyruar asnjë ndryshim në likuiditete;
- në DPV-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar shumën prej 5,000,000 lekësh, në vend të 1,500,000 lekësh si gjendje në datën 31.12.2005;
- në DPV-në e vitit 2006 është deklaruar mbyllja e kësaj depozite në shumën 510,972 lekë, kurse gjendja në datën 31.12.2006 ishte 0 lekë.

Pas hetimit të kryer nga Komisioni dhe dokumentacionit shkresor provues të paraqitur, subjekti nuk arriti të paraqesë dokumentacion të plotë provues dhe shterues lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj nga punësimi në shtetin grek (kontratat e punës, informacion për të ardhurat e përfituara, informacion për punëdhënësit, dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës në shtetin grek, etj.).

Lidhur me problematikat e konstatuara nga Komisioni në përgjigje të pyetëtorit nr. 3 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*“Pasaktësitë në pasqyrimin e pakësimit të depozitave bankare dhe ndryshimin e likuiditeteve lidhen me faktin se kam qenë e paqartë në plotësimin e deklaratave të para të pasurisë, kam menduar se ka qenë i mjaftueshëm thjesht deklarimi fillestar i depozitës bankare si burim i krijimit të pasurisë, ndërsa likuiditetet që janë tërhequr pjesë-pjesë për këtë investim kanë qenë të evidentueshme në bankë, kjo dhe për faktin se nuk kam pasur burim tjetër të ardhurash si burim për të investuar në ndërtimin e shtëpisë, përveç këtyre depozitave bankare.*

*Për këtë arsye dhe në deklaratën e vitit 2004 nuk kam deklaruar ndryshime në likuiditete, për faktin se nuk kam qenë e qartë për momentin e deklarimit të pasurisë shtëpi banimi, në momentin e fillimit të ndërtimit, apo kur të regjistrohej përfundimisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.*

*Në deklaratën e vitit 2005, kur kam deklaruar pakësimin e depozitës 5,000,000 lekë, i jam referuar vetëm burimit të krijimit të pasurisë, pa përcaktuar pakësimet periodike të tërhequra dhe gjendjen e depozitës bankare në fund të vitit 2005 dhe për këtë arsye kam pasqyruar në deklaratat vlerën totale të investimit dhe jo vlerën analitike dhe kronologjike të pakësimit të fondeve.*

*Ndërsa në deklaratën e vitit 2006 (të dorëzuar në mars të vitit 2007) kam deklaruar mbylljen e kësaj depozite bankare, sepse është mbyllur në datën 3.11.2006, ku në këtë datë bashkëshorti ka tërhequr shumën e ngelur në këtë depozitë prej 510,972 lekësh dhe detyrimisht në fund të vitit, në datën 31.12.2006, gjendja në këtë depozitë ka qenë 0.*

*Në lidhje me punën e bashkëshortit në emigracion në shtetin grek dhe të ardhurat e përfituara nga punësimi, i qëndroj sqarimeve që kam dhënë në pyetësin nr. 2 dhe provave bashkëlidhur. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga emigrimi (për vitet 1991 - 1999) jemi në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion më të plotë.*

*Kursimet nga të ardhurat nga puna në emigracion bashkëshorti i ka depozituar në vazhdimësi në depozitë bankare në Bankën Kombëtare të Greqisë, depozitë të cilën e ka hapur që në vitin 1991, konfirmuar ky fakt me ‘kërkesën për hapje llogarie bankare’ datë 15.10.1991, në emër të bashkëshortit A.Q., sipas origjinalit në arkiv në Bankën Kombëtare të Greqisë, dega e Bankës Arnea dhe vërtetimeve përkatëse të Bankës Kombëtare të Greqisë në lidhje me këtë llogari bankare.*

*Lidhur me emrat e punëdhënësve, sqaroj se në periudhën e fillimit të emigracionit bashkëshorti ka punuar në Mal të Shenjtë-Janoras (në Manastirin Agjios Pavlos) me punëdhënësin I. M., i cili e ka ndihmuar që të hapë edhe llogarinë e kursimit në bankën shtetërore (Bankën Kombëtare të Greqisë), në tetor të vitit 1991 në Jerisso-Kalkidhiki. Gjatë periudhës nga viti 1992 deri në vitin 1997 ka punuar në fshatin Erythres Atike (Kryekuqi), fshat arvanitas me origjinë shqiptare, në zonën e Thiva-Greqi, duke punuar në punë të ndryshme, kryesisht në ndërtimin apo meremetimin e shtëpive të shtetasve të ndryshëm grekë, ku ndërmjet punëdhënësve kujton shtetasit Th.P., Dh.P., Th.D., A.S., G.Z., S.Z., Th. Z., N.K., J.M., A.P., etj. (banorë në këtë fshat të Greqisë, disa prej të cilëve aktualisht kanë ndërruar jetë).*

*Në vitet 1998 - 1999 bashkëshorti A.Q., ka punuar në Selanik të shtetit grek së bashku me vëllain tim I.G., ku gjatë vitit 1998 ka punuar në një firmë ndërtimi me pronar M.R., ku gjatë kësaj periudhe punësimi ka përfutuar dhe sigurime shoqërore, duke u regjistruar në IKA. Por për shkak të kohës që ka kaluar bashkëshorti nuk e disponon këtë dokumentacion. Për këtë arsye ka aplikuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore Selanik, por deri më sot nuk është kthyer*



konfirmim për gjetjen e dokumentacionit të sigurimeve shoqërore në shtetin grek për këtë periudhë punësimi.

Konfirmoj faktet me dokumentet:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.4.2020, e bashkëshortit A.Q.;
- autorizim datë 17.10.2019, i bashkëshortit A.Q., legalizuar në Konsullatën e Përgjithshme të Greqisë në Korçë, duke autorizuar avokat P.D., pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Selanik, me nr. amze \*\*\* të Shoqatës së Avokatëve Selanik, lidhur me aplikimin e kërkesës pranë degëve përkatëse të Sigurimeve Shoqërore, për gjetjen dhe marrjen e vërtetimit të Sigurimeve Shoqërore Selanik në emër të A.Q., për vitin 1998;
- vërtetim aplikimi datë 21.2.2020, në emër të A.Q., në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve Selanik, drejtuar Drejtorisë së Informacionit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Selanik;
- deklaratë me përgjegjësi të shtetases greke E.P., datë 14.3.2019, me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 28.3.2019 (bashkëshortja e Th.P.), e cila konfirmon periudhën e qëndrimit dhe punësimit të A.Q., në Erythres Greqi si emigrant ekonomik;
- 'libër shëndeti fëmije' të vajzës P.Q., e datëlindjes 7.7.1994, lindur në Athinë Greqi, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë në Greqi;
- vërtetim datë 8.6.2018, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Kostur (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon gjetjen e llogarisë bankare në emër të A.Q., me nr. \*\*\* dhe gjendjen e lëvizjeve të llogarisë bankare, siç rezultuan nga verifikimi në arkivën e bankës;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2019, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega e Bankës Arnea (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon faktin se në llogarinë bankare të bashkëshortit janë realizuar depozitime dhe tërheqje njëkohësisht të shumës 4,948,780,00 dhrahmi, si dhe nuk është e mundur dhënia e kopjeve të mandateve të depozitimit dhe tërheqjes së të hollave të llogarisë;
- vërtetim datë 10.6.2019, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Kostur (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon se arkivat e mandateve të viteve 1991 - 1997 janë asgjësuar për arsye se ka kaluar periudha 20-vjeçare dhe nuk ekzistojnë kopje të mandateve dhe ndërmjet tyre edhe transferta e shumës 2,500,000.00 dhrahmi, e kryer në datën 22.6.1994;
- vërtetim datë 26.6.2019, të Bankës Kombëtare të Greqisë, dega Kostur (legalizuar me vulë apostile nr. \*\*\*, datë 4.3.2020), i cili konfirmon pamundësinë për gjetjen e veprimeve të tjera të kryera në llogarinë e bashkëshortit për arsye se ka kaluar periudha 20-vjeçare.”

Në analizën financiare të hartuar nga Komisioni nuk janë përfshirë të ardhurat e deklaruara nga emigracioni dhe as të ardhurat e interesave të gjeneruara nga depozitat e krijuara me paratë e emigracionit, sepse nuk u provua burimi i ligjshëm i këtyre depozitave.

#### **Në përfundim Komisioni vlerëson se:**

Bazuar në sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se me anë të shpjegimeve të dhëna dhe provave të dërguara, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave. Më tej, nuk arriti të provojë burimin e krijimit (nëse ka qenë i punësuar) të të ardhurave dhe përderisa nuk provoi burimin, subjekti i rivlerësimit nuk arriti as të provonte ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, sipas parashikimeve të nenit D, të pikës 3, të Aneksit të Kushtetutës, ku specifikohet se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji

*konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore... ”.*

**4. Depozitë në bono thesari** në Bankën e Shqipërisë (hapur në datën 9.11.2010 nga mbyllja e depozitës në “ProCredit Bank”), aktualisht e pakësuar. Vlera 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare.

Krijimi i kësaj depozite është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratën periodike vjetore të dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2010.

#### **Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit**

- Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë depozitë të deklaruar nga subjekti.

**5. Autoveturë tip “Mercedes Benz”,** viti i prodhimit 1989, targa KO \*\*\* , me leje qarkullimi nr. KO \*\*\*. Vlera 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare.

Gjatë hetimit rezultoi se kjo pasuri e luajtshme është blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* , datë 26.5.2003, në vlerën prej 300,000 lekësh.

Blerja e kësaj pasurie dhe vlera e saj është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratën para fillimit të detyrës të dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2010.

Mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie janë përfshirë në analizën financiare, si më poshtë:

Të ardhura 1997 – maj 2003	2,479,472
Shpenzime jetese 1997 – maj 2003	1,622,512
Blere makine maj 2003	300,000
<b>Mundësia financiare</b>	<b>556,960</b>

#### **Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit**

- Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri të luajtshme të deklaruar nga subjekti.

#### **6. Lidhur me pasuritë në përdorim të subjektit të rivlerësimit**

Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banuar nga viti 2000 – në maj të vitit 2007 në një apartament në pronësi të shtetasit N. O.Th. Apartamenti është përdorur nga subjekti dhe familjarët e saj pa pagesë qiraje, por është deklaruar se subjekti ka paguar detyrimet për furnizim me ujë, energji dhe taksa të tjera, për këtë periudhë qëndrimi. Për këtë subjekti ka paraqitur dhe një deklaratë noteriale të shtetasit N.O.Th., lëshuar në datën 16.7.2019.

Meqenëse përgjigjja e subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur nuk ishte shteruese iu kërkua që subjekti të deklaronte burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe një informacion më të përgjithshëm lidhur me marrëdhëniet e saj dhe të bashkëshortit me këtë person.

Gjithashtu, lidhur me problematikat e konstatuar nga Komisioni në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*“Burim krijimi i kësaj pasurie ka qenë privatizimi i banesës nga N.Th., që në vitin 1993 me adresë Rr. “\*\*\*”, apartament 1+1 në katin e pestë, pall. \*\*\*. Praktika e privatizimit është regjistruar në ZVRPP-në Korçë në vitin 1999 sipas kartelës së pasurisë, me pronarë N.O.Th.,*

dhe M.B.Th., (bashkëshortë). Në vitin 2005 është pajisur me certifikatën e pronësisë lëshuar në datën 5.4.2005. Aktualisht deri më sot janë pronarët e vetëm të kësaj banese dhe nuk ka ndryshim pronësie.

Bashkëshorti A.Q., ka krijuar njohje dhe lidhje shoqërore me N.Th., që në periudhën e emigracionit, duke qenë nga e njëjta krahinë (zona e Korçës dhe Kolonjës), sepse dhe N., ka emigruar në shtetin grek që në vitin 1991. Para viteve 1990 N., ka punuar veteriner dhe rrjedh nga një familje e nderuar korçare, babai i tij O.Th., ka qenë ish -pedagog themelues i Universitetit 'Fan Noli' në Korçë dhe nëna e tij N.Th., ka qenë punonjëse e Arkës së Kursimeve dhe më pas edukatore kopshti. N., jeton me bashkëshorten M., dhe nga martesat nuk kanë fëmijë. Bashkëshorti kur është shkëputur përfundimisht nga emigracioni, duke qenë të lidhur miqësisht ka biseduar me N., (mëqenëse shtëpia e tij qëndronte e mbyllur prej largimit të tyre në Greqi) dhe kanë rënë dakord që ta përdorte dhe mirëmbante apartamentin e tij pa qira dhe të paguante shpenzimet drita ujë. Marrëdhëniet ndërmjet familjeve tona janë korrekte dhe miqësore. N., me bashkëshorten nuk është kthyer asnjëherë të jetojë në atdhe dhe vazhdojnë të jetojnë në shtetin grek, ku aktualisht janë rezidentë në Halkida Greqi.

*Bashkëlidhur ju vë në dispozicion:*

- praktikën e privatizimit të apartamentit nga N.Th., në datën 7.4.1993;
- certifikatë për vërtetim pronësie për apartamentin në pronësi të N.O.Th., dhe M.B.Th., lëshuar në datën 5.4.2005;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.4.2020, e bashkëshortit A.Q.”.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

- Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri të luajtshme të deklaruar nga subjekti.

### **7. Lidhur me përfitimet**

#### **7.1 Lidhur me përfitimin nga babai i bashkëshortit**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëshorti ka përfituar një shumë nga babai në shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2008 dhe, si provë, ka paraqitur deklaratë noteriale të tij të lëshuar në datën 29.10.2009.

Bazuar në këtë deklaratë rezulton se deklaruesi S.Q., i ka dhënë të birit në vitin 2008 shumën në fjalë, por nuk përmendet kthimi i saj. Më pas është deklaruar se kjo shumë, së bashku me interesat dhe shtesat, i është kthyer babait të bashkëshortit të subjektit. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka paraqitur disa dokumente, por pa provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume.

Rezultoi se në datën 7.2.2008 bashkëshorti i subjektit ka investuar vlerën prej 1,000,000 lekësh në bono thesari. Këtë vlerë e ka tërhequr në datën 13.2.2009.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë si përfitim nga babai.

Lidhur me këto konstatime të Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë dokumentacion provues lidhur me burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të babait të bashkëshortit për krijimin e shumës prej 1,000,000 lekësh, si dhe të deklarojë dhe të provojë se kur, kjo shumë, i është kthyer babait të bashkëshortit.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

“Nuk disponoj dokumentacion tjetër provues përveç atyre që kam dorëzuar në pyetësin nr.2.

Ky veprim ka qenë thjesht një marrëdhënie ndërmjet bashkëshortit dhe atit të tij, për të kryer një veprim financiar në bankë për llogari të babait të tij S.P.Q., duke çelur depozitë në bono thesari në Bankën e Shqipërisë Dega Korçë, për të cilën deklaroj me përgjegjësi se nuk kam pasur dijeni. Pasi është plotësuar afati i depozitës bashkëshorti ka tërhequr këtë shumë dhe bashkë me interesat ia ka kthyer të atit në shkurt të vitit 2009, pra, kur është mbyllur kjo depozitë.

Këto lekë ishin kursimet ndër vite që dispononte vjehri në shtëpinë e tij nga të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale, nga shitja e bagëtive të imta dhe gjedhëve që kishte në pronësi, si dhe nga të ardhurat nga pensioni. Jeton në fshatin Rehovë të Kolonjës dhe ka punuar mësues deri sa ka dalë në pension në vitin 1987. Më pas ka punuar në bujqësi dhe blegtori. Të tre fëmijët i ka pasur në emigracion në Greqi, ku djali tjetër K.Q., vazhdon aktualisht të jetë rezident në Kalohori, Selanik, Greqi. Duke qenë se ka ngelur i ve që në vitin 2003 ka jetuar i vetëm dhe ka shitur bagëtitë duke krijuar të ardhura të cilat i ka kursyer.

Kjo shumë lekësh nuk është përdorur për asnjë lloj shpenzimi apo investimi në familjen time dhe nuk ka shërbyer si burim krijimi të ndonjë pasurie.

Për të vërtetuar këtë fakt paraqes si prova:

- deklaratat noteriale nr. \*\*\*, datë 20.6.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 6.3.2020, të vjehrit S.P.Q., i cili konfirmon akumulimin e kësaj shume si kursime nga të ardhurat ndër vite, nga prodhimet bujqësore nga puna e tokës në fshat, ka pasur në pronësi bagëti të imëta e gjedhë duke marrë prodhime blegtorale dhe nga shitja e tyre ka përfutur të ardhura të mira. Po kështu, konfirmon faktin e kthimit të kësaj shume nga djali i tij (bashkëshorti, pasi është mbyllur depozita bankare;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.3.2020, e kryeplakut të fshatit S.Z., i cili konfirmon faktin se vjehri disponon tokë në pronësi dhe ka krijuar të ardhura ndër vite nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale, si dhe faktin se ka krijuar të ardhura nga shitja e bagëtive.
- akt i marrjes së tokës në pronësi, certifikatat e pronësisë së tokës;
- vërtetimin e të ardhurave nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Korçë për vjehrin S.P.Q., ku pasqyrohen të ardhurat nga pensionet nga viti 1987 – 31.12.2008 në vlerën prej 1,443,872 lekësh dhe nga periudha 1.1.2009 – 9.2.2020 në vlerën prej 2,588,534 lekësh.”

### **Analiza financiare e mundësisë së z. S.Q., për të dhënë shumën prej 1,000,000 lekësh për investim**

Pension total S.Q., periudha 1987 – 2007	1,274,404
Shpenzim jetese 1 person	1,138,477
Dhënë A.Q.,	1,000,000
<b>Pamundësi financiare</b>	<b>- 864,073</b>

Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të këtij përfitimit nga ana e z. S.Q. Në analizën financiare vlera e përfutur prej 1,000,000 lekësh në vitin 2008 dhe kthimi i vlerës 1,100,000 lekë në vitin 2009, nuk është përfshirë.

### **Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit**

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shumën prej 1,000,000 lekësh në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008.
- Babai i bashkëshortit të rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj shume në vitin 2008.

Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, nuk arriti të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni dhe as të provojë mundësitë financiare dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtij likuiditeti.

Bazuar në analizën financiare rezultoi se personi i lidhur, z. S.Q., kishte pamundësi financiare për krijimin e këtij likuiditeti në vlerën prej -864,073 lekësh.

#### **Në përfundim Komisioni vlerëson se:**

Referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”*

Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume nga personi tjetër i lidhur/babai i bashkëshortit, në vlerën prej 1,000,000 lekë.

Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për vitin përkatës.

#### **7.2 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga vëllai i subjektit**

Subjekti ka deklaruar se ka përfituar të ardhura në shumën prej 400,000 lekësh, nga i vëllai, z. I.G.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar të ardhurat e tij gjatë viteve të punës në Greqi. Duket se shtetasi I.G., ka qenë i punësuar me dokumentacion të rregullt, por nuk ka informacion të saktë mbi të ardhurat e tij para periudhës së dhurimit.

Në analizën financiare, Komisioni këtë dhurim e ka përfshirë tek të ardhurat e vitit 2005, në vlerën prej 400,000 lekësh.

Nëse subjekti nuk arrin të provojë burimin e ligjshëm të këtij përfitimit nga ana e z. I.G., atëherë vlera e përfituar prej 400,000 lekësh në vitin 2005 nuk do të përfshihet në analizën financiare.

#### **Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit**

- Vëllai i subjektit të rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për t'i dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 400,000 lekësh.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti arriti të paraqesë pjesërisht disa prova dhe shpjegime lidhur me mundësitë financiare të vëllait për të ardhura të krijuara në shtetin grek.

Për sa kohë subjekti nuk provoi plotësisht mundësitë financiare të vëllait dhe dokumentacioni i sjellë nuk ishte konform legjislacionit shqiptar, Komisioni nuk mori në konsideratë të ardhurat e përfituara prej vëllait të saj.

Në analizën financiare, nuk janë përfshirë të ardhurat e pretenduara nga ky dhurim i deklaruar.

## **Në përfundim Komision vlerëson se:**

Referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*”

Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume nga personi tjetër i lidhur/vëllai i subjektit, në vlerën prej 400,000 lekësh.

Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për vitin përkatës.

## **8. Lidhur me të ardhurat e prindërve të subjektit**

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar së bashku me prindërit e saj për një periudhë kohe (mars 1995 – tetor 1998) dhe në këtë periudhë shpenzimet e jetesës janë mbuluar prej tyre.

Lidhur me këtë deklaram subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion provues lidhur me mundësitë dhe burimet financiare të prindërve për këtë periudhë.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*“Sqaroj se babai H.G., ka punuar minator nëntokë dhe ka dalë në pension në vitin 1987 në moshën 50 vjeçare, kurse nëna H.G., ka punuar në Kombinatin e Trikotazhit Korçë dhe ka dalë në pension në vitin 1993. Babai si bashkëthemelues i Ndërmarrjes Bujqësore në qytetin e Korçës është trajtuar me tokë bujqësore në përdorim që në vitin 1991 dhe më pas në pronësi. Të dy prindërit duke qenë aktivë për punë, kanë punuar tokën dhe prodhimet bujqësore babai i tregtonte si shitës ambulant në tregun e fruta- perimeve në qytetin e Korçës. Këtë aktivitet e ka ushtruar që kur ka marrë tokën në përdorim dhe deri në vitin 2006 (kur ka mbushur moshën 70 vjeç). Për vetë periudhën e kohës nuk kërkohej nipt apo licencë për shitjen e produkteve bujqësore nga fermerët e qytetit dhe fshatarët e zonës, por kryenin vetëm pagesë ditore për vendin në treg. Si rrjedhojë e shitjeve të produkteve bujqësore prindërit kanë krijuar në vazhdimësi të ardhura (përpos faktit që dhe në familje konsumonim nga këto prodhime bujqësore dhe nuk shpenzonim për blerjen e tyre). Po kështu, prindërit kanë pasur të ardhura nga pensionet, si dhe të ardhura nga puna në emigracion e vëllait I.G., (emigrant ekonomik nga 1991 – 2006), i cili në ardhjet e tij periodike ka sjellë kursime në familje.*

*Konfirmoj faktet më sipër me dokumentet:*

- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2020, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Korçë të të ardhurave të z. H.G., për periudhën 13.8.1987 – 31.12.2005, në masën 1,071,066 lekë dhe për periudhën 1.1.2006 – 29.2.2020, në masën 3,813,395 lekë, si dhe tabelën përmbledhëse sipas viteve;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Korçë të të ardhurave të znj. H.G., për periudhën 1.1.1994 – 31.12.2005, në masën 786,491 lekë dhe për periudhën 1.1.2006 – 29.2.2020, në masën 2,270,771 lekë, si dhe tabelën përmbledhëse sipas viteve;
- akti i marrjes se tokës në përdorim dhe pronësi dhe certifikata e pronësisë së tokës;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.4.2020, e prindërve H., dhe H.G., të cilët konfirmojnë burimin e krijimit të të ardhurave nga shitja e produkteve bujqësore, si dhe kursimet e vëllait në emigracion;

- vërtetim datë 18.2.1998 i Policisë Greke, Drejtoria e Sigurimit Selanik, për z. I.G., për t'u depozituar në shërbimin përkatës të Zyrës së Punë për pajisje me lejë qëndrimi;
- lejë qëndrimi me kohë të kufizuar, të Ministrisë së Punës dhe Sigurimeve Shoqërore për vitet 2000 – 2001;
- librezë personale shëndeti me nr. amze të sigurimeve shoqërore \*\*\* dhe nr. amze të sigurimeve shëndetësore \*\*\*;
- librezë punësimi në ndërtim dhe vepra arti, datë 18.9.2002, lëshuar nga Instituti Sigurimeve Shoqërore të shtetit grek (IKA);
- vërtetim 'të dhënat për sigurimet shoqërore sektori i ndërtimit', datë 26.6.2019 dhe 23.7.2019 me vulë apostile;
- kartë anëtarësimi origjinale te Sindikata e Punonjësve të Ndërtimit Selanik me nr. \*\*\*."

### **Analiza e mundësisë së kursimit të H., dhe H.G.,**

Pension total H., + H.G., vitet '83 – '99	612 071
Shpenzime jetese çifti G., + Rozeta Qirjaqi me fëmijë	1 103 306
<b>Mundësi kursimi</b>	<b>-491 235</b>

Nga kjo analizë rezultoi se prindërit e subjektit H., dhe H.G., nuk kanë pasur mundësi financiare për mbulimin e shpenzimeve të jetesës së subjektit bashkë me fëmijët e saj, gjatë periudhës 1991 – 1999.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti nuk arriti të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni dhe as të provojë mundësitë financiare të prindërve për përballimin e shpenzimeve të jetesës.

Bazuar në analizën financiare prindërit e subjektit janë në pamundësi financiare për të kursyer në vlerën prej -491,235 lekësh.

### **Në përfundim konstatohet se:**

- Për këto të ardhura është bërë deklaram i pasaktë.
- Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për përballimin e shpenzimeve të jetesës.

### **9. Lidhur me depozitat bankare ndër vite të subjektit**

Pas hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se në ish-Bankën Amerikane subjekti ka kryer shtim të llogarive bankare në vlerën prej 5,000 USD dhe më pas në vitin 2008 me një vlerë tjetër prej 4,000 USD.

Depozitat dhe shtimet e shumave përkatëse janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI.

Nisur nga fakti se nuk ishte deklaruar burimi, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të deklaronte dhe të provonte burimin e shtimit të shumës prej 4,000 USD në vitin 2008.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

*“Shtimi i shumës 4,000 USD në depozitën bankare në ish-Banka Amerikane, ka burim krijimi kursimet nga paga ime, të akumuluar në banesë gjatë vitit 2007 dhe në tremujorin e parë të vitit 2008. Sasinë e lekëve të kursyer në shumën prej 400,000 lekësh e kam konvertuar në dollarë amerikane dhe kjo shumë është bërë shtim në depozitën bankare në datën 16.4.2008.*

Vërtetim për të ardhurat nga paga nr. \*\*\* prot., (J. N), datë 20.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për periudhën shtator 1989 – korrik 2008.

Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për të ardhurat nga paga, për periudhën gusht 2008 – tetor 2016.

Statement bankar, datë 16.4.2008, të Amerikan Bank (sot 'Intesa Sanpaolo Bank').”

### **Analiza e mundësisë së kursimit për hapjen e depozitës në shumën 4,000 USD në vitin 2008**

Të ardhura për 3 muaj 2008	244,843
Shpenzime jetese për 3 muaj	34,155
Hapje depozite 4.000 USD	363,840
<b>Pamundësi financiare</b>	<b>-153,152</b>

Në analizën e mundësisë financiare për depozitim të vlerës prej 4,000 USD në vitin 2008 janë marrë parasysh vetëm të ardhurat nga pagat për 3-mujorin e parë të vitit 2008.

Për vitin 2007 nuk merren në llogaritje të ardhurat sepse subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në fund të vitit 2007.

#### **Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit**

- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për shtimin e kësaj llogarie bankare me 4,000 USD, si dhe kryerjen e shpenzimeve të jetesës, në shumën prej -153,152 lekë.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti nuk arriti të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për të provuar të kundërtën e gjetjeve të konstatuara nga Komisioni dhe as të provojë mundësitë financiare për shtimin e kësaj llogarie bankare.

Bazuar në analizën financiare subjekti është në pamundësi financiare për të shtuar këtë depozitë me 4,000 USD, si dhe kryerjen e shpenzimeve të jetesës në vlerën prej - 153,152 lekë.

#### **Në përfundim konstatohet se:**

*Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj depozite bankare.*



## ANALIZA FINANCIARE

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ROZETA H., QIRJAQI																
	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>PASURI</b>	<b>8,073,863</b>	<b>267,909</b>	<b>-38,664</b>	<b>-130,670</b>	<b>-64,104</b>	<b>-13,477</b>	<b>1,565,994</b>	<b>-1,088,792</b>	<b>70,842</b>	<b>-2,381</b>	<b>-146,401</b>	<b>-468,228</b>	<b>-30,374</b>	<b>55,985</b>	<b>-58,196</b>	<b>15,365,583</b>
Toke trual 300m2 *** (***) Korçë - 1996 - 50%	300,000															300,000
Shtëpi banimi 141m2 - 2004 - 2006 ne truallin Korçë - 50%			3,550,247	2,522,271	919,202											6,991,720
Autoveture Benz *** - A.Q.,- 2003 - 100%		300,000														300,000
Likuiditete Rozeta Qirjaqi para 2003	635,147															635,147
Likuiditete A.Q., para 2003	7,138,716															7,138,716
																0
<b>Ndryshim ne likuiditet</b>		<b>-32,091</b>	<b>-3,588,911</b>	<b>-2,652,941</b>	<b>-983,306</b>	<b>-13,477</b>	<b>1,565,994</b>	<b>-1,088,792</b>	<b>70,842</b>	<b>-2,381</b>	<b>-146,401</b>	<b>-468,228</b>	<b>-30,374</b>	<b>55,985</b>	<b>-58,196</b>	<b>0</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
																0
																0
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>8,073,863</b>	<b>267,909</b>	<b>-38,664</b>	<b>-130,670</b>	<b>-64,104</b>	<b>-13,477</b>	<b>1,565,994</b>	<b>-1,088,792</b>	<b>70,842</b>	<b>-2,381</b>	<b>-146,401</b>	<b>-468,228</b>	<b>-30,374</b>	<b>55,985</b>	<b>-58,196</b>	<b>15,365,583</b>
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>2,834,023</b>	<b>677,244</b>	<b>971,026</b>	<b>1,075,837</b>	<b>968,039</b>	<b>1,009,596</b>	<b>1,131,796</b>	<b>1,406,753</b>	<b>1,820,530</b>	<b>1,879,942</b>	<b>1,424,937</b>	<b>1,493,581</b>	<b>1,506,373</b>	<b>1,854,403</b>	<b>1,854,373</b>	<b>21,908,453</b>
Te ardhura Rozeta Qirjaqi	2,834,023	677,244	971,026	1,075,837	968,010	1,009,567	1,059,128	1,404,079	1,488,225	1,492,895	1,420,515	1,404,504	1,479,737	1,512,372	1,493,102	20,290,265
Te ardhura A.Q.,		0	0	0	0	0	71,708	0	325,439	382,806	0	89,077	26,636	342,031	346,872	1,584,569
Te ardhura P.Q.,				0	29	480	1,337	3,433	2,120	2,211	0	0	0	0	14,399	24,009
Te ardhura K.Q.,					29	0	480	1,337	3,433	2,120	2,211	0	0	0	0	9,610
																0
<b>SHPENZIME</b>	<b>1,967,858</b>	<b>375,856</b>	<b>472,756</b>	<b>1,824,006</b>	<b>1,338,228</b>	<b>758,704</b>	<b>653,010</b>	<b>576,480</b>	<b>616,480</b>	<b>627,177</b>	<b>738,178</b>	<b>1,439,556</b>	<b>1,254,992</b>	<b>1,272,104</b>	<b>1,458,368</b>	<b>15,373,753</b>
Shpenzime jetese	1,967,858	375,856	375,856	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	10,168,178
Taksa per ndertimin e shtepise ne Korçe			96,900													96,900
shpenzime arsimimi per femijet								30,000	70,000	65,000	68,000	18,000	25,000	25,000	168,000	469,000
Shpenzime qiraje dhe jetese vajza ne Tirane											105,000	350,000	350,000	350,000	350,000	1,505,000
Shpenzime arredimi				700,000	300,000	200,000										1,200,000
Shpenzime punime shtese ne shtepi				600,000	600,000											1,200,000
Shpenzime per shtese investimi ne bono thesari - 2008 - A.Q.,							100,000									100,000
Shpenzim nga shlyerja e BTH viti 2013												507,460				507,460
Shpenzime udhetimi				85,778	0	12,224	6,530			15,697	6,986					127,215
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>-7,207,698</b>	<b>33,479</b>	<b>536,934</b>	<b>-617,499</b>	<b>-306,085</b>	<b>264,369</b>	<b>-1,087,208</b>	<b>1,919,065</b>	<b>1,133,208</b>	<b>1,255,145</b>	<b>833,160</b>	<b>522,253</b>	<b>281,755</b>	<b>526,314</b>	<b>454,201</b>	<b>-9,218,491</b>
																<b>Pamundësia financiare</b>
																<b>-9,218,491</b>

Bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit, nuk ka pasur mundësi financiare për vitet 1994 – 2016, në vlerën totale prej 9,218,491 lekësh.

Komisioni, për këtë analizë financiare, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të paraqesë prova dhe dokumentacion justifikues për të provuar të kundërtën e disa gjetjeve të konstatuara nga Komisioni.

### **Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare**

Në analizën financiare janë përfshirë gjendjet e depozitave të krijuara nga shtetasi A.Q., para vitit 2003 në bazë të të dhënave bankare. Gjithashtu, janë të përfshira edhe të ardhurat nga interesi i depozitave, si dhe i depozitave të tjera që rrjedhin nga ato fillestare.

Subjekti duhet të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre të ardhurave, në të kundërt, të ardhurat nga interesi i këtyre depozitave nuk do të përfshihen në analizë.

Analiza financiare e hartuar nga Komisioni nuk është përfundimtare dhe mund të ndryshojë në varësi të provave dhe të shpjegimeve që mund të sjellë subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

Komisioni, gjatë kësaj analize, është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe të personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga të gjitha bankat e nivelit të dytë : Credins Bank, Raiffeisen Bank, Banka e Shqipërisë, Tirana Bank, Intesa Sanpaolo Bank, ish-Banka Amerikane, Union Bank, OTP Bank, BKT, ProCredit Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

- të ardhurat nga pagat e subjektit në, Prokurorinë e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Korçë (1989 – 2008), Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë (2008 – 2016);
- të ardhurat nga interesi në bono thesari në Bankën e Shqipërisë (2010 – 2016);
- të ardhurat nga interesi në “ProCredit Bank” (2010) dhe “Raiffeisen Bank” (2002 – 2004);
- të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit te shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. (2010 – 2011), “\*\*\*\*” sh.p.k. (2013), si dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (2014 – 2016);
- të ardhurat nga interesi në bono thesari në Bankën e Shqipërisë (2008);
- të ardhurat nga interesi nga dhe depozita e subjektit në “Raiffeisen Bank” (2002 – 2004);
- të ardhurat nga pagat e vajzës së subjektit pranë shoqërisë “\*\*\*\*” (2016), si dhe të ardhurat nga interesi te “ProCredit Bank” (2007 – 2012); dhe
- të ardhurat nga pagat e djalit të subjektit, si dhe nga interesi te “ProCredit Bank” (2007 – 2012).

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit te familjes nga INSTAT), bashkëngjitur shkresa nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së;
- shpenzime arredimi dhe punime shtesë (llogaritur në vlerën 1,200,000 lekë shpenzime arredimi + 1,200,000 lekë për punime shtesë), arsimim fëmijësh, qiraje dhe të tjera për vajzën gjatë banimit në Tiranë (2012 – 2016), shpenzime në vitin 2013 pas shlyerjes së një pjese nga bonot e thesarit, të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni;
- shpenzimet e udhëtimit.

Metodologjia për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit.

Udhëtimet jashtë vendit do të evidentohen sipas të dhënave të sistemit *TIMS*, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor të vitit/viteve për të cilin/për të cilat përlllogariten shpenzimet e udhëtimit.

Shpenzimet e përlllogaritura në valutë do të konvertohen në lekë sipas kursit mesatar vjetor të publikuar nga Banka e Shqipërisë, përveç rasteve kur kursi i këmbimit është përcaktuar shprehimisht në aktet shkresore justifikuese për transaksionin përkatës ose kur data e transaksionit është e provuar me akt shkresor, rast në të cilin do të aplikohen kurset e datës së kryerjes së transaksionit, sipas të njëjtit burim zyrtar.

### **Shpenzimet e qëndrimit**

Shpenzimet e qëndrimit për udhëtime jashtë vendit, për personat e rritur (18+ vjeç) llogariten në vlerën 50 euro/USD për çdo ditë qëndrimi, për fëmijët (5-18 vjeç) 25 euro/USD për çdo ditë qëndrimi dhe për fëmijët (0 - ditën që mbush 5 vjeç) në vlerën 15 euro/USD për çdo ditë qëndrimi.

Për efekt të përcaktimit të kostove të qëndrimit jashtë Shqipërisë është mbajtur në konsideratë legjislacioni i zbatueshëm në fuqi, lidhur me dietat, si: udhëzimi i ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”; seksioni 3.6 “shpenzime të panjohura”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 8.5.2003, “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit”; si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Në rastin në fjalë, në përlllogaritje janë zbatuar për analogji parashikimet e akteve nënligjore për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit. Monedha në të cilën do të përlllogariten shpenzimet përcaktohet në varësi të vendit të qëndrimit. Si rregull, për qëndrimin në një shtet të Evropës do të përdoret monedha euro, kurse për qëndrimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përdoret dollari amerikan.

Në rastet kur nga subjekti i rivlerësimit provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë, atij/atyre do t’u llogariten vetëm sasia e shpenzimeve personale prej 5 euro/USD.

### *Shpenzimet e transportit tokësor*

Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit me automjet, kur është i njohur/i deklaruar destinacioni, përlllogariten sipas formulës: shpenzime totale udhëtimi = distanca (në km) x konsum karburanti x çmimi mesatar/litër + shpenzime për certifikatën ndërkombëtare të sigurimit të automjetit (karton jeshil). Lidhur me këtë formulë, elementet përcaktohen si më poshtë: distanca në km evidentohet nga vendi i nisjes në vendin e mbërritjes nëpërmjet: [www.google.com/maps/dir/](http://www.google.com/maps/dir/); ° konsumi i karburantit merret në vlerë standarde prej 7 litra/100 km (për çdo lloj automjeti); çmimi mesatar për litër karburanti të konsumuar përlllogaritet bazuar në të dhënat e publikuara në <https://ec.europa.eu/energy/en/data-analysis/weekly-oil-bulletin> për llojin diesel/naftë.

Shpenzimet për certifikatën ndërkombëtare të sigurimit të automjetit (karton jeshil) përlllogariten: 0 euro për destinacionin Kosovë; 15 euro për destinacionin Mali i Zi; 40 euro për vende të tjera.

Në rast mungese të informacionit për destinacionin e saktë të udhëtimit dhe për pikën kufitare të daljes, shpenzimet për kartonin jeshil përlllogariten në vlerën 15 euro.

Për udhëtimet jashtë vendit me automjet, kur nuk është deklaruar destinacioni i saktë, por verifikohet pika kufitare e daljes, konsiderohet si destinacion qyteti më i afërt me kufirin dhe përlllogaritjet kryhen si më sipër. E njëjta mënyrë vlerësimi ndiqet edhe në rastet kur nuk është deklaruar destinacioni i saktë (qyteti), por vetëm vendi i hyrjes dhe, në këtë rast, si destinacion merret qyteti më i afërt nga pika kufitare për në vendin e hyrjes dhe përlllogaritjet e shpenzimeve kryhen si më sipër.

Në të gjitha rastet kur udhëtimi është kryer me automjet, por nuk identifikohet pika kufitare e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, si e tillë do të konsiderohet vendkalimi kufitar më i afërt me vendbanimin e subjektit të rivlerësimit/personit të lidhur dhe përlllogaritjet e shpenzimeve të udhëtimit do të kryhen si më sipër.

Në rastet kur subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur me të kanë udhëtuar me automjet të cilin nuk e kanë në pronësi/përdorim dhe provojnë se kanë qenë pasagjerë, shpenzimet e transportit nuk do të përlllogariten.

## **ARSYETIMI LIGJOR DHE ANALIZA E PASURIVE DHE TË ARDHURAVE SË BASHKU**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar “Vetting” të vitit 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, si dhe deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (iv) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përmes postës elektronike; (v) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore; dhe (vi) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të kuptohet më qartë raporti midis pasurive të deklaruara dhe të ardhurave të ligjshme, si dhe analiza ligjore e veçantë për çdo pasuri konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke bërë deklaram të rremë, duke fshehur burimin e vërtetë të krijimit të këtyre pasurive, duke bërë deklaram jo të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të pasurive të përmendura në këtë vendim, sipas paragrafit 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në përputhje me paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**DSIK-ja**, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me

parashikimet e pikës 4, të nenit 4 dhe nenet 37 dhe 38, të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin përfundimtar ku rezultoi se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Pas hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se nipi i subjektit të rivlerësimit, z. J.G., është person i ndaluar dhe i ndjekur penalisht në vitin 2016, për veprën penale “prodhim dhe shitje lënde narkotike”, ku rezultoi dhe dënimi i tij më pas nga gjykata.

Ky fakt duket se nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën përkatëse për vlerësimin e figurës.

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këtë fakt për dënimin e nipit të saj në formularin e vlerësimit të figurës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e saj në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar se:

- *Kategoria e veprës penale së kryer nga nipi nuk përfshihet në kategorinë e krimit të organizuar.*
- *Nipi është ndjekur penalisht për veprën penale përcaktuar nga neni 283 i Kodit Penal.*
- *Prej vitit 2015 nuk kam pasur kontakte me familjen e vëllait dhe as me nipin e saj, si dhe skam pasur dijeni për veprimet e tij.*

Në përfundim nga Komisioni konstatohet se:

- Nipi i subjektit të rivlerësimit është arrestuar në datën 4.5.2015 dhe ndaj tij është marrë menjëherë masa e “arrestit me burg”. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.4.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur deklarinim fajtor të nipit të subjektit për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim. Për kryerjen e kësaj vepre penale nipi i subjektit të rivlerësimit është dënuar me 4 vjet e 6 muaj burgim.
- Vepra penale për të cilën është arrestuar dhe dënuar më pas nipi i subjektit të rivlerësimit, përfshihet në kategorinë e veprave penale të parashikuara nga pika 1, e nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (përcaktuar nga pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”).
- Subjekti ka pasur detyrim ligjor që të deklaronte në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa 5 “të dhëna për sigurinë” pika “b”, faktin se ndonjë nga anëtarët e familjes është përfshirë në krimin e organizuar.
- Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk ishin bindëse, pasi nipi i saj është ndjekur penalisht, si person i përfshirë në krimin e organizuar, për vepra penale që janë objekt i ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit pavarësisht kontakteve ka pasur detyrimin ligjor të merrte të dhëna nga organet ligjzbatuese (pjesë e këtyre organeve është dhe vetë subjekti), lidhur me procedimin ose dënimin e pjesëtarëve të familjes (rrethi i personave për të cilën subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor për deklarinim).

## **Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit**

Pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, përcakton se personi i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person i dënuar (me përjashtim të rastit kur është i deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë) ose proceduar penalisht.

Rezultoi se nipi i subjektit të rivlerësimit ka qenë i proceduar penalisht dhe me masë “arrest në burg” si person i dyshuar për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, në kohën e plotësimit të formularit për kontrollin e figurës nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim pika 2, e neni 39, të ligjit nr. 84/2016, e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e mosplotësimit të saktë dhe jo me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës. Për këtë shkak, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit të subjektit, përderisa nuk ka mundur të provojë të kundërtën, sipas nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

## **C. VLERËSIMI I AFËSIVE PROFESIONALE**

Raporti i vlerësimit profesional është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit:

- a) *aftësitë profesionale;*
- b) *aftësitë organizative;*
- c) *etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe*
- ç) *aftësitë personale dhe angazhimi profesional.*

Raporti është hartuar dhe bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të prokurorisë.

### **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit konkluzion përfundimtar dhe rekurse, si më poshtë:

1. Çështja penale nr. \*\*\*, viti 2015, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në ngarkim të të pandehurit V.B., akuzuar për veprën penale “korrupsion pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”.
2. Çështja penale nr. \*\*\*, viti 2008, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në ngarkim të të pandehurit K.K., akuzuar për veprën penale “vrasja me dashje” dhe “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”.
3. Çështja penale nr. \*\*\*, viti 2013, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në ngarkim të të pandehurit Y.Z., akuzuar për veprën penale “kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”.

*Nuk janë konstatuar problematika nga Komisioni lidhur me tri dokumentet ligjor të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit.*

### **Përshkrimi i pesë dosjeve penale për subjektin e rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, të përzgjedhura me short**

**1. Konkluzion për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit E.D., në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 13.2.2013, që bën fjalë për veprën penale “mbajtja pa leje e**

**municioneve luftarake” dhe “mbajtja pa leje e municioneve të armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga nenet 278/3 dhe 280 të Kodit Penal.**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë të pandehurin E.D., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “mbajtja pa leje e municioneve luftarake” dhe “mbajtja pa leje e municioneve të armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga nenet 278/3 dhe 280 të Kodit Penal.

Me vendimin penal nr. \*\*\*, datë 14.6.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka vendosur:

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit E.D., për veprat penale të “mbajtja pa leje e municioneve luftarake” dhe fajtor për veprën penale “mbajtja pa leje e municioneve të armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga nenet 278/3 dhe 280 të Kodit Penal.

Kundër këtij vendimi ka bërë apel prokurori i çështjes, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe deklarinimin fajtor të të pandehurit.

Gjithashtu, kundër këtij vendimi ka bërë ankim i pandehuri E.D., ku ka kundërshtuar veprimet arbitrare të policisë që kanë të bëjnë me kontrole të banesës së shtetasve që nuk janë përfshirë në asnjë veprimtari kriminale. Në ankimin e tij i pandehuri ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe deklarinimin të pafajshëm për veprën penale të “mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive” të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal.

Prokurorja Rozeta Qirjaqi ka kërkuar ndryshimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 14.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe ka kërkuar:

-Deklarimin fajtor të të pandehurit E.D., për kryerjen e veprës penale të “mbajtja pa leje e municioneve luftarake” të parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) muaj burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit E.D., për kryerjen e veprës penale të “mbajtja pa leje e municioneve të armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.

-Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve dhe dënimin me 9 (nëntë) muaj burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurave Penale dënimin përfundimisht me 6 (gjashtë) muaj burgim.

Mbi bazën e argumenteve të paraqitur nga prokurorja ka kërkuar ndryshimin e vendimit, kërkesë e gjetur e drejtë dhe e pranuar nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\* datë 21.11.2013.

**2. Konkluzion për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit O.M., në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2013, që bën fjalë për veprën penale “zbulim të akteve ose të dhënave sekrete”, të parashikuar nga neni 295/1 i Kodit Penal.**

Pas përfundimit të veprimeve hetimore, prokuroria ka dërguar për gjykim procedimin penal në ngarkim të shtetasit O.M., në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me vendimin penal nr. \*\*\*, datë 13.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka vendosur:

-Deklarimin fajtor të të pandehurit O.M., për veprën penale të “zbulim të akteve ose të dhënave sekrete” të parashikuar nga neni 295/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 150.000 (njëqind e pesëdhjete mijë) lekë gjobë.

Kundër këtij vendimi në datën 15.10.2014 ka ushtruar të drejtën e ankimit mbrojtësi i të pandehurit O.M.

Prokurorja Rozeta Qirjaqi, në cilësinë e prokurores së apelit, në konkluzionet e saj ka kundërshtuar pretendimet e ngritura në ankimin e të pandehurit, duke paraqitur argumentet

përkatëse dhe në përfundim, ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit penal nr. \*\*\*, datë 13.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.5.2015, Gjykata e Apelit Korçë pas shqyrtimit të çështjes, pretendimeve të ngritura nga i pandehuri dhe kërkesës së parashtruar nga prokurorja, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

**3. Konkluzion për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit A.P., në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2014, që bën fjalë për veprat penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë plagosjen e rëndë të një personi, “drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe “largimi nga vendi i aksidentit”, të parashikuar nga nenet 290/2, 291 dhe 273 të Kodit Penal.**

Pas përfundimit të veprimeve hetimore, prokuroria ka dërguar për gjykim procedimin penal në ngarkim të këtij shtetasi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me vendimin penal nr. \*\*\*, datë 10.2.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka vendosur:

-Deklarimin fajtor të të pandehurit A.P., për veprën penale të “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” të parashikuar nga nenet 290/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 muaj burgim.

-Deklarimin fajtor të të pandehurit A.P., për veprën penale të “drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga nenet 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit A.P., për veprën penale të “largimi nga vendi i aksidentit” të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 muaj burgim.

-Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal për bashkimin e dënimeve të caktohet dënim me 18 muaj burgim.

-Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale duke i ulur 1/3 e dënimit e dënon përfundimisht të pandehurin me 12 muaj burgim.

-Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vendosur të dënuarin A.P., në provë për një afat 18 muaj, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës, Zyra Vendore Korçë.

Kundër këtij vendimi në datën 20.2.2015 ka ushtruar ankim prokurori i çështjes, me pretendimin për aplikim të gabuar të nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim të të pandehurit A.P.

Prokurorja Rozeta Qirjaqi, në cilësinë e prokurores së apelit, në konkluzionet e saj ka përshkruar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është pjesërisht i gabuar për sa i përket aplikimit të alternativës së dënimit me burgim të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

Në përfundim të veprimeve të kryera, prokurorja Rozeta Qirjaqi ka kërkuar ndryshimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 10.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vetëm për sa i përket alternativës së dënimit dhe mosaplikimit të nenit 59 të Kodit Penal për të pandehurin A.P.

Baza ligjore sa i përket kërkimeve të prokurorit është e saktë, neni 428/1, germa “b”, i Kodit të Procedurës Penale. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk paraqet të meta.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2015, Gjykata e Apelit Korçë, pas shqyrtimit të çështjes dhe kërkesës së parashtruar nga prokurorja, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 10.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Rozeta Qirjaqi, nuk ka qenë dakord me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 10.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe për arsyet e parashtruara më lart ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, bazuar në nenet 432/1/a dhe 441/1/b të Kodit të Procedurave Penale, duke kërkuar



ndryshimin e vendimeve penale vetëm për sa i përket alternativës së dënimit me burgim dhe mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

#### **4. Konkluzion për çështjen penale në ngarkim të shtetasit Y.Z., me objekt caktim mase sigurimi.**

Gjykata, pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2013, ka vendosur:

- Të vlerësojë si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit Y.Q.Z.

- Caktimin si masë sigurimi personale ndaj shtetasit Y.Q.Z., atë të arrestit në burg, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurave Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka marrë në shqyrtim provat e vëna në dispozicion nga organi i akuzës lidhur me shtetasin Y.Z., në bazë të të cilave ka krijuar bindjen se ekziston dyshimi i bazuar që ky shtetas ka kryer veprën penale për të cilën është nisur procedimi penal. Aktet e paraqitura nga prokuroria konsistojnë në materialet procedurale që shoqërojnë kërkesën për vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit të paraqitur në datën 4.12.2013.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, në cilësinë e prokurores së apelit, ka parashtruar në konkluzionet e saj përpara kësaj gjykate se gjykata e shkallës së parë, në marrjen e vendimit të apeluar, ka respektuar kërkesat e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për të caktuar masën e sigurimit personal ndaj shtetasit Y.Z.

Sikundër ka pranuar edhe gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, në lidhje me veprën penale për të cilën është akuzuar i pandehuri.

Në përfundim, prokurorja Rozeta Qirjaqi, ka kërkuar nga gjykata e apelit miratimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 6.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Baza ligjore sa i përket kërtimeve të prokurorit është e saktë, neni 249 i Kodit të Procedurës Penale. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk paraqet të meta.

Mbi bazën e argumenteve të paraqitura prokurorja ka kërkuar miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë të ankimuar, kërkesë e gjetur e drejtë dhe e pranuar nga gjykata e apelit.

#### **5. Konkluzion për çështjen penale me objekt “kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015” me kërkues K.J., dhe K.K.**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 15.7.2015 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur nga shtetasit K.J., dhe K.K., në ngarkim të shtetasit I.N., për kryerjen e veprave penale “shpërdorim të detyrës”, “kryerje e veprimeve arbitrare”, “ndikimi për ndalim të paligjshëm nga policia”, “shkelje e barazisë së shtetasve”, “njoftim të rremë të organeve të rendit publik” dhe “mosekzekutim të vendimit gjyqësor”, të parashikuara nga nenet 248, 250, 251, 253, 272 dhe 320/1 të Kodit Penal.

Ky vendim mosfillimi është ankimuar në gjykatën e shkallës së parë nga kallëzuesit dhe gjykata ka disponuar me vendim rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar të ligjshëm vendimin e marrë nga prokurori për mosfillimin e procedimit penal. Ky disponim i gjykatës së shkallës së parë është bërë objekt ankimi në gjykatën e apelit nga kallëzuesi, i cili ka parashtruar faktin se prokuroria nuk ka vlerësuar drejt problemin e mosrespektimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 2.4.2015, i cili përbën veprën penale.

Në cilësinë e prokurores së apelit, subjekti i rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, pasi ka shqyrtuar vendimin gjyqësor të shkallës së parë të ankimuar, si dhe pretendimet e ankuesit, ka parashtruar

para Gjykatës së Apelit Korçë se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë duhet të lihet në fuqi, si i drejtë, i mbështetur në ligj e në provat e administruara gjatë gjykimit.

Në analizën e saj, prokurorja Rozeta Qirjaqi ka vënë në dukje se nga veprimet verifikuese të kryera nga organi procedues rezulton se është administruar vendimi së bashku me dosjen përkatëse për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015, në lidhje me të njëjtin fakt të pretenduar në kallëzimin e ri penal. Në këtë vendim organi procedues i ka dhënë zgjidhje ligjore pretendimeve të kallëzuesve K.J., dhe K.K., për sa i takon problemeve që lidhen me paligjshmërinë e pezullimit të tyre nga detyra, veprës penale të “punësimit të paligjshëm”, si dhe për veprën penale të “veprimeve arbitrare”, pretendime të cilat janë ringritur sërish në kalimin objekt hetimi. Edhe pretendimi që lidhet me urdhrat për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së kallëzuesit, pretendimet për veprimet arbitrare të punonjësve të komisariatit të policisë, janë pretendime të cilave iu është dhënë një zgjidhje përfundimtare me vendimin e mësipërm të mosfillimit të procedimit penal, me të cilin kallëzuesit janë njohur dhe nuk e kanë ankimuar në gjykatë.

Për sa i takon pretendimit lidhur me pagën e punonjësve K.J., dhe K.K., në kushtet kur në vlerësimin e tyre paga nuk mbështetet në VKM-në nr. 805, datë 26.11.2015, as në vendimin e Këshillit të Qarkut, me të drejtë organi procedues ka vlerësuar se ky është një pretendim i karakterit civil, për të cilat kallëzuesit kanë të drejtë ti drejtohen gjykatës për t’i kundërshtuar me cilësinë e një akti administrativ. Të gjitha shkeljet e pretenduara prej kallëzuesve dhe të listuara dhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 17.6.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nuk duhet të jenë objekt i vlerësimit të prokurorisë për sa kohë që periudha kohore brenda të cilit është lënë afat për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë drejtim nuk ka përfunduar deri në momentin e marrjes së vendimit prej organit procedues. Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2015, të Këshillit të Qarkut Korçë drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë, rezulton se institucioni është duke ndjekur të gjitha hapat ligjore në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil. Ndonëse edhe në kallëzimin e parë janë ngritur pretendime lidhur me veprimet arbitrare të bëra prej titullarëve të institucionit, ky është një pretendim që referon në një ngjarje të disa muajve më parë nga çasti i kallëzimit dhe nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në kuptim të nenit 272 të Kodit Penal “njoftim i rremë i bërë në organet e rendit”, në rastin konkret nuk jemi përpara elementeve të kësaj vepre penale, pasi punonjësit e policisë (të cilët në raste të tilla duhet të ishin subjektet që duhet të paraqisnin kallëzimin) kanë disponuar me ndalimin apo shoqërimin për disa orë (tre orë) në komisariat të kallëzuesve dhe nuk është shoqëruar me fillimin e ndonjë procedimi penal për shkak të ekzistencës së ndonjë vepre penale të denoncuar nga ana e tyre, ashtu sikurse kërkon specifikisht dispozita e sipërcituar.

Për sa i takon pretendimit të kallëzuesve lidhur me mosekzekutimin e vendimit të gjykatës nr. \*\*\*, datë 2.4.2015, prej shtetasës I.N., nuk rezultojnë elementet e veprës penale të “pengimit të ekzekutimit të vendimit” të parashikuar nga neni 320/1 i Kodit Penal, sepse e kallëzuara, në cilësinë e Kryetares së Këshillit të Qarkut, si punëdhënëse nuk ka kundërshtuar në gjykatë ndonjë veprim përmbarimor, përkundrazi ka filluar ekzekutimin e vendimit duke shlyer pagesat për kallëzuesit dhe ka nisur procedurat për risistemimin në punë.

Në këto rrethana me të drejtë është konkluduar në përfundimin se faktet e përmendura prej kallëzuesve i janë nënshtruar një herë një vendimmarrje të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.

Në përfundim, prokurorja Rozeta Qirjaqi ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit penal nr. \*\*\*, datë 3.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Baza ligjore sa i përket kërtimeve të prokurorit është e saktë, neni 428/1, germa “a” dhe neni 291 i Kodit Procedurave Penale. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk paraqet të meta.

Mbi bazën e këtyre argumenteve, prokurorja ka kërkuar edhe lënien në fuqi të vendimit të ankimit, kërkesë e gjetur e drejtë dhe e pranuar nga gjykata e apelit, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.12.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 3.9.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

### **Në përfundim nga Komisioni konstatohet se:**

*Lidhur me pesë dosjet e përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika që kanë të bëjnë me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.*

Sipas të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë periudhës së rivlerësimit, për subjektin Rozeta Qirjaqi nuk kanë rezultuar ankesa të asnjë natyre dhe as masa disiplinore, të përfunduara apo në fuqi. Për prokuroren Rozeta Qirjaqi vlerësimet e punës të kryera për tri vitet e periudhës së rivlerësimit kanë :

- Vlerësimi “shumë mirë” dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014 – 2016.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, ka aftësi mjaft të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe aftësi në arsyetimin ligjor. Aktet e përpiluar prej saj, konkluzione përfundimtare në gjykimin në shkallë të dytë, janë të qartë, të arsyetuar mirë dhe plotësisht të kuptueshëm.

Subjekti rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e prokurores pranë Prokurorisë së Apelit Korçë, duke përfaqësuar në gjykim organin e Prokurorisë për rastet kur është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit.

Për sa iu përket të dhënave stastistikore, nga prokurorja Rozeta Qirjaqi janë deklaruar 977 çështje të caktuara përgjatë viteve 2014 – 2016, ka përfunduar 965 çështje dhe ka mbartur gjithsej 12 çështje të vitit 2016 për vitin 2017.

Në dosjet e vëzhguara evidentohet aftësi në organizimin e punës, respektim i afateve të gjykimit dhe përpjekje për të zgjidhur në mënyrë të drejtë çështjen. Nga aktet e analizuara nuk u konstatuan vonesa apo zvarritje të qëllimshme në përfaqësimin në gjykimin në apel të çështjeve, që ka çuar edhe në zgjidhjen brenda afateve kohore të përshtatshme.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, ka kryer veprimtarinë e përfaqësimit të akuzës në gjykimin në shkallë të dytë në mënyrë produktive.

### **DENONCIMET**

Për subjektin e rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, janë paraqitur denoncimet, si më poshtë:

1. Denoncim nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, datë 2.2.2018, i shtetases Xh.Q.  
Denoncuesja denoncon subjektin e rivlerësimit për veprime të kryera me 2 standarde.
2. Denoncim nr. \*\*\*, datë 12.10.2018, i shtetases i A.Xh.  
Ky denoncim është paraqitur në formën e kërkesës për heqje dorë nga një çështje gjyqësore.
3. Denoncim nr. \*\*\*, datë 12.12.2019, i shtetases V.P.  
Denoncuesja denoncon subjektin e rivlerësimit për pasurinë dhe për mbështetjen e dhënë ndaj nipit të dënuar.
4. Denoncim nr. \*\*\* datë 8.1.2020; nr. \*\*\*, datë 13.1.2020; nr. \*\*\* datë 15.1.2020; dhe nr. \*\*\*, datë 16.1.2020, i shtetaset V.N.
5. Denoncim nr. \*\*\*, datë 21.2.2020, i shtetases E.M.  
Denoncimi ka të bëjë me ndikimin e subjektit për uljen e dënimit të nipit J.G.

Lidhur me denoncimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit në rezultatet e hetimit iu kërkua të paraqesë shpjegime.

Pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit nuk u konstatuan problematika nga Komisioni, që kanë të bëjnë me përgjegjësi apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në 2 (dy) prej kriterëve të vlerësimit, atë të pasurisë dhe të figurës, në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti e rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi:

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1991 – 2016;
- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për të ardhurat;
- ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm;
- ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;
- nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të saj dhe të personave të lidhur në kuptim të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës; si dhe
- nuk ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës procedimin dhe dënimin e nipit të saj, sipas nenin 283/2 të Kodit Penal.
- 

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Rozeta Qirjaqi, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.7.2020.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda Çiftja**

**Kryesues**

**Firdes Shuli**

**Anëtar**

**Roland Ilija**

**Relator**

*Gledis Hajdini*  
*Sekretare gjyqësore*